



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT, PROJEKTI “REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË
NË
FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, PROJEKTI
“REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS”

NËNTOR 2022

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	9
II. HYRJA.....	12
1. Objekti i auditimit	12
2. Qëllimi i auditimit	12
3. Identifikimi i çështjes:	12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	12
5. Përgjegjësitë e Audituesve:	13
6. Kriteret e vlerësimit.....	13
7. Standardet e auditimit.....	13
8. Metodot e auditimit	14
9. Dokumentimi i auditimit	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	16
1. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....	16
2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.....	16
2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.	19
2.3 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.....	22
2.4 Mbi prokurimin e fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.	25
2.5 Mbi zbatimin e kontratave në drejtim të realizimit të punimeve.	29
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	39
V. ANEKSE.....	51

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

FSHZH është një OJF e cila gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, me Statutin, Manualin e Procedurave, me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Fusha e veprimtarisë së FSHZH^{së} është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit me fokus rajonal, lokal dhe territorial, në interes të publikut. Objektivat e këtij institucioni janë:

a. përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore;

b. përmirësimi i shërbimeve publike vendore;

c. nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Kompetencat përshkruhen si më poshtë:

a. menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor;

b. dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format: si grant, hua, garanci dhe forma të tjera për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

c. dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

d. dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor;

e. kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Projekti objekt auditimi “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” është një Projekt i cili ka parashikuar lidhjen e segmentit rrugor që lidh rrugën nacionale Levan – Tepelenë (SH4), rrugën nacionale Vlorë Sarandë si dhe një segment i cili lidhet me Qytetin e Vlorës. Projekti përfaqëson një rrugë sekondare që lidh 81 fshatra në 3 Bashkitë, konkretisht Vlorë, Selenicë dhe Himarë. Projekti ka një gjatësi prej 94.2 km dhe konsiston në ndërtimin e veprave të vogla dhe të mëdha të artit, shtresa të reja rrugore si dhe elementët e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore. Për këtë segment, në vitin 2014 FSHZH, ka angazhuar konsulentë për të hartuar projektin e fizibilitetit nga ana e të cilit është përlogaritur një kostot totale investimi prej 78,000,000 USD pa TVSH ose 93,600,000 USD me TVSH, për realizimin e 94.2 km rrugë, përfshirë këtu edhe shërbimin e supervizionit. Ky projekt ka parashikuar objektivat si më poshtë:

- Përmirësimi i aksesit për turistët dhe vizitorët;
- Përmirësimi i aksesimit në rrugë;
- Disponueshmëria më e shpeshtë e shërbimeve të transportit dhe reduktimi i kostos dhe kohës së udhëtimit;
- Rritja e aksesit në tregun lokal dhe atë rajonal për shitjen e produkteve;
- Ulja e nivelit të papunësisë në zonë përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe intensifikimit të aktiviteteve aktuale ekonomike;
- Diversifikimi i ekonomisë lokale nëpërmjet aktiviteteve promovuese të eko-turizmit;
- Rritja e punësimit dhe mundësive për të ardhura për popullsinë lokale;
- Përmirësimi i ndërveprimit social dhe aksesit në aktivitete sociale, sportive dhe kulturore;
- Reduktimi i familjeve të cilat jetojnë në varfëri;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve parësore;

Në terma të përfitimit ekonomik, projekti i propozuar do të krijojë një aks të ri tërheqës i cili do të jetë më i shkurtër, do të ketë shpejtësi më të madhe lëvizjeje, ulje të kostove të operimit

të makinave, raport më të ulët Volum/Kapacitet prej nga kemi dhe nivel më të lartë shërbimi, kohë më e shkurtër udhëtimi, emetime më të ulëta të gazit të shkarkimit si dhe një nivel më të lartë të komoditetit në udhëtimi për sa i takon trafikut gjatë vijës bregdetare.

Pas lidhjes së marrëveshjes me vlerën e 12,000,000 KD ose afërsisht 39,500,000 USD, nga ana e ARRSH, në bazë të Projektit të Fizibilitetit është hartuar Projekti Teknik i Zbatimit vlera e të cilit është përlogaritur në shumën prej 219,803,064 USD me TVSH pa përfshirë këtu vlerën e supervizionit.

Për sigurimin e fondeve të projektit rezulton se janë lidhur në total 3 marrëveshje, nga të cilat, dy me Fondin Kuvajtian në shumën afërsisht prej 61,500,000 USD (39,500,000 USD Marrëveshja e 2016 + 22,000,000 USD marrëveshja e 2020) si dhe një me Fondin Saudit në shumën prej afërsisht 30,000,000 USD. Pra, në total janë lidhur marrëveshje në shumën 113,500,000 USD. Këto fonde janë parashikuar të shpenzohen në drejtim të Projektit për kontrata punimesh civile dhe konsulence si më poshtë:

Tabela nr. 1

KONTRATAT E PUNIMEVE						
Nr.	Objekti i Kontratës	OE/BOE	Vlera e Kontratës (lekë me TVSH)	Data e lidhjes së Kontratës	Afati	Statusi
<u>1</u>	<i>Loti I - Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm</i>	A. T.	2,002,817,718	24.02.2017	24 muaj +3 muaj amendim kontrate	Përfunduar punimet më dt. 30.06.2019
<u>2</u>	<i>Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos</i>	S.	4,236,665,117	17.04.2019	24 muaj	Përfunduar punimet 12.05.2021
<u>3</u>	<i>Loti III - Ura e Laskos – Qeparo dhe Ura e Laskos – Rruga e lidhjes me Kuçin'</i>	I.	3,540,036,147	08.05.2020	24 muaj	Në proces, nisur punimet më datë 08.05.2020
KONTRATAT E KONSULENCËS						
<u>1</u>	<i>Supervizimin e punimeve Lot I, II dhe III</i>	P.	2,173,178 (Euro me TVSH)	18.01.2018	48 muaj	Në proces

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab, datë 30.03.2016, është përcaktuar se komponentët kryesore të projektit do të jenë si më poshtë: 1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës; 2. Shtrimi i sipërfaqes; 3. Rehabilitimi i kullimit, duke përfshirë ura, tombino, mure mbajtës, gjithashtu siguria dhe ndriçimi, etj. 4. Shërbimi i konsulencës. Gjithashtu, objektivi kryesor i projektit është përcaktuar realizimi i punimeve në përputhje me standardet e pranuar dhe qëndrueshmëria e infrastrukturës publike, në zonën e Bregdetit të Jugut, specifiku në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale. Në zbatim të kërkesave	19 – 22	E lartë	1. Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, nëpërmjet Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, si edhe Njësisë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të marrë masa për vlerësimin aktual të objektivave të matshëm për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” deri në përfundimin e projektit me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë të infrastrukturës urbane dhe përfundimin me sukses të rehabilitimit të rrugës të Lumit të Vlorës. 2. Drejtori Ekzekutiv i FSHZH të marrë masa për ndryshimet përkatëse të marrëveshjeve të investimeve me bashkitë, për të

Shtojca 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, është lidhur Kontrata e Shërbimit të Konsulencës për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit “J. E.” në datë 18.01.2018. Në Shtojcën A, pika II Objektivat, të kontratës së sipërcituar (ToR) është përcaktuar se projekti do të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të përfitimeve social-ekonomike dhe ambientale si më poshtë: -Mundësinë e hyrjes në rrugën e përmirësuar; -Mundësi më e madhe për lidhjen me tregjet rajonale dhe lokale për tregtimin e produkteve lokale, përmirësimin e ndërveprimit social; -Uljen e papunësisë nëpërmjet krijimit të punëve të reja dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese; -Diversifikimin e ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve të turizmit; -Bashkëveprimin social të përmirësuar dhe rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive; -Pakësimin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, etj. Nga auditimi, nuk rezulton vlerësimi i këtyre objektivave. Në pikën 2, Shtojca B “Kërkesa Raportuese” të Kontratës Konsulencës është përcaktuar se Raporti Fillestar do të përshkruaj planin që Konsulencia ka vendosur lidhur me detyrat e saj, si edhe stafin, gjithashtu edhe vërejtjet siç ajo i gjykon. Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të komentojë këtë Raport. Gjithashtu, në seksionin VI, Shtojca A, të Kontratës së Konsulentit, është përcaktuar Raporti Fillestar (Inception Report) i konsulentit me elementet kryesore përbërës, dhe që përfshin synimet dhe objektivat e projektit, gjithashtu Manualin e Kontrollit të Cilësisë bashkëlidhur, por që nga auditimi nuk rezulton që FZHSK ka administruar një raport të tillë. Në Kontratën e Punës, Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, paragrafi i shtuar i nën-pikës 34.1, në pjesën e parë të paragrafit është përcaktuar që për aq sa është e mundur Kontraktori duhet të punësojë punëtorë lokal. Nga auditimi, nga ana e Klientit nuk është provuar me të dhëna zyrtare se Kontraktori ka respektuar kriterin e mësipërm. Në seksionin II, Shtojca A, “Përshkrimi i Projektit” të Kontratës së Konsulentit është përcaktuar se ndërtimi i infrastrukturës urbane përbëhet nga trotualet, zonat e parkimit, ndriçimi publik, vendosja e kabllit optik, instalimi i sinjalistikës rrugore, etj. Nga raportet e konsulentit nuk rezulton të jetë raportuar në mënyrë të veçantë për infrastrukturën urbane, gjithashtu mbi realizimin e hyrjeve-daljeve të fshatrave të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës, për pasojë nuk rezulton e qartë edhe mënyra dhe përgjegjësia e realizimit të tyre. Nga raporti teknik i projekt-zbatimit, vetëm për Lot 1 p.sh. janë përcaktuar rreth 60 hyrje – dalje të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka lidhur marrëveshjet e investimit me bashkitë përkatëse, respektivisht me Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Selenicë datë 26.01.2017, si edhe me Bashkinë Himarë datë 21.03.2017. Në nenin 3 të marrëveshjeve të sipërcituara, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të janë të angazhuara, midis të tjerave me detyrimin, që të japë informacione dhe të dhëna në kuadër të kësaj marrëveshje, përfshirë të dhëna të mbledhura nga përfituesit dhe të dhëna shtesë të kërkuara nga FSHZH apo Supervizori. Gjithashtu, në nenin 5 “Për realizimin e punimeve” të Marrëveshjeve të Investimit është përcaktuar se me përfundimin e punimeve, për çdo prej kontratave të punimeve, gjatë inspektimeve të tyre duhet të marrin pjesë, dhe për pasojë duhet të firmosin edhe Certifikatat e Përfundimit të Punimeve bashkitë respektive, gjë që nga dy lotet e para kjo gjë nuk rezulton të ketë ndodhur. Sa sipër, duke qenë se pronari i rrugës që rehabilitohet është Autoriteti Shqiptar Rrugor, kontratat e mësipërme nuk kanë krijuar mundësi për funksionimin e duhur midis aktorëve të projektit dhe për këtë arsye ato duhet të përmirësohen. Veprimet dhe mosveprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë mungesën e			përcaktuar kërkesa dhe përgjegjësi të qarta vendimarrjen nga ana NjVV për pjesë e tyre të territorit, ashtu edhe për pjesëmarrjen e tyre si aktorë në realizimin e projektit.
---	--	--	--

	vlërësimit të objektivave të projektit <i>“Rehabilitimi i rrugës të Lumit të Vlorës”</i>.			
2	Referuar pjesës së financimit të Kredisë nr. 943, për Projektin për sa i përket kontratave të sipërmarrjeve të punimeve për Lot I dhe Lot II është konstatuar se në pesë raste disbursimet e IPC^{ve} nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në klauzolën nr. 60.11 të kontratave. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se janë hasur vonesa në disbursimin e IPC^{ve} për pjesën takuese prej 77 % të mbuluar Fondi Kuvajtian. Nga këto 5 raste, në 2 prej tyre, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 889 prot., datë 07.06.2019, nga ana e Kontraktorit për LOT 1 <i>“A.M.”</i>, janë paraqitur ankesa (<i>Claim</i>) për IPC^{te} 5 dhe 6. Në vijim të korrespondencave mes Fondit Kuvajtian, FSHZH, Kontraktorit dhe Supervizorit është dakordësuar mes palëve tërheqja për ankesën me datë 03.07.2019 në takimin e muajit.	23 – 26	E lartë	Nga FSHZH, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Përgjegjësi i Njësisë së Projektit të merren masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse duke shmangur të gjitha praktikatat penguese në disponibilitetin e fondeve në mënyrë që procesi i pagesave të IPC^{ve} të realizohet brenda afateve të përcaktuar në kontratë duke eliminuar mundësitë për penalitete (<i>Claim</i>) nga kontraktorët.
3	Në Marrëveshjen Financiare të ratifikuar me ligjin nr. 50/2016 datë 5.5.2016 me vlerë financimi 12,000,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,828,677,230 lekë) konstatohet se, nuk është parashikuar mënyra e lëvrimit të shumave të huas nga Fondi Kuvajtian. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky lëvrim është kryer si më poshtë: Pas marrjes së aplikimit nga FSHZH, Fondi Kuvajtian urdhëron Bankën Kombëtare të Kuvajtit për disbursimin e shumave të aplikuara dhe në këtë moment njoftohet edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë me anë të dokumentit <i>Debit Advice</i> për urdhër transfertën; Nga Banka Kombëtare Kuvajtiane shuma lëvrohet në një llogari në B.N.Y; Kjo shumë kalon më pas nga B.N.Y në llogari të kontraktorit apo konsulentit, sipas rastit. Mos parashikimi i procedurës dhe afatit të nevojshëm për lëvrimin e fondeve deri në llogarinë e përfituesit final si dhe kalimi i pagesave në hallkat e mesipërme ka sjellë si rezultat vonesa në disbursimin e pagesave pjesore (IPC), duke mos u respektuar afatet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve dhe asaj të konsulencës e duke e ekspozuar FSHZH si implementues të Projektit ndaj riskut për penalitete nga ana e Kontraktorëve (<i>Claim</i>).	23 – 26	E lartë	1. Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që, në fazën e negociimeve me donatorët, draft - Marrëveshjet Financiare të përfshijnë edhe mënyrën e lëvrimit të shumave të huas në llogari të përfituesit final. 2. Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që gjatë lidhjes së kontratave të cilat financohen nga donator të huaj në afatet e pagesave të parashikuara në to, të përfshihen edhe afatet të cilat i duhen donatorit për të kryer disburimin final për pjesën takuese, duke shmangur penalitetet e mundshme.
4	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: 1- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore nga IPC nr. 1 deri tek IPC nr. 10; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Praktikrat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3; Etj. 2- Korrespondencat mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve; si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar (IPC nr. 10) volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në dy zërat me vlerat përkatëse nw shumwn prej 1,307,114 lekë pa TVSH.	31 – 41	E lartë	1. Nga ana e FSHZH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arëtimin e vlerës 1,307,114 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE A. T. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 24.02.2017 me nr. CWC/ICB/2016/1 me objekt <i>“Rindërtimi i rrugës Vlorë bypass – Peshkepi – Ura Gjorm Lot I”</i>. 2. FSHZH të marrë masa për shmangien e praktikave në të cilat konstatohen mbivendosje zërash të ndryshëm për të njëjtët procese pune me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve të projekteve.
5	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, rezulton se Kontraktori A.M. ka nisur punimet në datën 30.03.2017 me njoftimin për fillimin e punimeve nga mbikëqyrësi i përkohshëm i emëruar nga klienti (FSHZH). Me Vendimin nr. 04, datë 27.03.2017 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH (Klienti), është emëruar z. Xh. N. si mbikëqyrës i përkohshëm i punimeve për objektin <i>“Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës aksi Selenicë-Kuç-Qeparo”</i> Lot 1. Në fakt veprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë rezultuar në kundërshtim me kërkesat	31 – 41	E lartë	Drejtori Ekzekutiv i FSHZH me Departamentin e Menaxhimit të Projekteve dhe Njësinë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të analizojnë rezultatet e dy loteve të para të projektit <i>“Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”</i>, si edhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për një koordinim më të mirë midis aktorëve përgjegjës për realizimin e projektit brenda

e Shtojcës 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, për zgjedhjen e konsulentit. Gjithashtu, nuk është respektuar Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, neni 122 pika 2 ku përcaktohet përparësia e marrëveshjeve ndërkombëtare, në rastin kur ligjet e vendit nuk pajtohen me të. Në shkresën e kontraktorit Ref. Nr. ATM/BA/pmt/006 datë 09.06.2017, drejtuar klientit (FSHZH), është bërë me dije mungesa e funksionimit të mbikëqyrësit të përkohshëm. Me shkresën e sipërcituar është njoftuar klienti (FSHZH), se nuk është marrë akoma njoftimi zyrtar për fillimin e punimeve, gjithashtu nuk është rishikuar nga mbikëqyrësi i përkohshëm programi në vendin e punimeve dhe përcaktimi i buxhetit me ndryshimet e mundshme përkatëse. Kërkesa e sipërcituar nga Kontraktori është mbështetur në Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, ku përcaktohet se inxhinieri (konsulentit) i caktuar nga punëdhënësi vepron si inxhinier për qëllimet e kontratës dhe jo si inxhinier thjesht i emëruar. Gjithashtu, sipas pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b) inxhinieri siguron aprovimin specifik përpara se klienti (FSHZH) të ushtrojë autoritetin e tij. Mbikëqyrësi i përkohshëm, gjatë periudhës 30.03.2017-31.01.2018, nuk ka mundur të ushtrojë veprimtarinë e tij për kontrollin dhe certifikimin e punimeve të kryera. Mbikëqyrësi, duke qenë një individ i emëruar, nuk plotësonte kushtet lidhur me kapacitetet e konsulentit të parashikuara në termat e referencës, ku është parashikuar një staf me disa inxhinierë mbikëqyrës në vend, inxhinierë të kontrollit të cilësisë, inxhinierë topograf, si edhe specialist ambienti, etj. Qëllimi i shërbimit të mbikëqyrjes (konsulentit apo inxhinierit), konform pikës 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi), është të sigurojë implementimin e projektit në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike, si dhe të sigurojë që shërbimet teknike të jenë të lidhura me interpretimet e dokumenteve të kontratës, kontrollin e shpenzimeve, certifikimin e materialeve, volumet dhe faturat e dorëzuara nga Kontraktori, gjithashtu, ndryshime të tilla të projektit dhe specifikimeve teknike që bëhen të domosdoshme gjatë realizimit të projektit. Nga ana e klientit (FSHZH) nuk është provuar me dokumente, raportime dhe akte që mbikëqyrësi i përkohshëm të ketë ushtruar kontrollet e sipërpërmendura, orientimet (instruksionet), dhe certifikimet e punimeve përkatëse. Nga auditimi konstatohet se Kontraktori ka kryer punime në vlerën prej 686,634,246 lekë pa TVSH për periudhën 30.03.2017-30.01.2018, dhe për shkak të mungesës të funksionimit të mbikëqyrjes (certifikimin e punimeve dhe miratimit të situacioneve përkatëse) nuk ka marrë asnjë pagesë. Kontrata e shërbimit të konsulencës për projektin <i>“Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”</i>, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit J.E. është lidhur në datë 18.01.2018, ndërkohë që punimet kishin filluar në datë 30.03.2017. Nga shërbimi i konsulencës është miratuar Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës (IPC) nr. 1 datë 21.05.2018 për periudhën e punimeve 30.03.2017-31.03.2018 dhe për volumet që janë mbështetur me dokumente justifikues, në vlerën prej 395,110,145.00 lekë ose 23.7 % e vlerës gjithsej prej 1,669,014,765 lekë pa TVSH, të parashikuara në preventivin fitues të tenderit. Sa sipër, Kontraktori ka patur një progres të ulët të kryerjes së punimeve. Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës nr. 1 (IPC nr. 1) është dorëzuar nga Kontraktori për shqyrtim tek konsulentit në datë 24.04.2018. Certifikata e Marrjes në Dorëzim (TOC) është lëshuar nga konsulentit në datën 26/11/2019. Certifikata Finale e Pranimit, pas periudhës së përgjegjësisë për defektet, është lëshuar në datën 26.11.2020. Veprimet e Fondit Shqiptar të zhvillimit rezultojnë në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017 dhe pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b), gjithashtu në kundërshtim me pikën 1			afateve të parashikuara nga Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab.
---	--	--	---

	shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi) si dhe me kushtet teknike të parashikuara në projektin e zbatimit, duke shkaktuar si pasojë kryerjen e punimeve nga Kontraktori pa miratimin paraprak dhe pa certifikimin e konsulentit, në vlerën prej 686,634,246 lekë pa TVSH. Këtë e vërteton jo vetëm fakti se për periudhën në fjalë Kontraktori nuk ka përfituar asnjë pagesë nga klienti, por edhe fakti që punimet e kryera për periudhën e mësipërme janë certifikuar për herë të parë nga konsulenti i përzgjedhur J.E., i cili ka filluar veprimtarinë në fillim të Shkurtit 2018. Veprimet e Klientit në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator kanë shkaktuar rritjen e riskut për kryerjen e punimeve jashtë standardeve të parashikuara në specifikimet teknike. Faktikisht sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga inspektimi në vendin e punimeve të konsulentit, në datat 19-20 Qershor 2018, është gjetur se Kontraktori nuk ka përmbushur specifikimet teknike për shtresën e zhavorrit të imët (ana e djathtë e rrugës) në seksionet si më poshtë: -km 1+600-km 1+670 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur 5-10 cm - km 1+950-km 2+125 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur më pak se 10 cm. Sipas seksionit 28.02, pika 4 e Specifikimeve Teknike, gjerësia e seksionit tërthor të shtresës duhet të ishte 20 cm. Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara (përfshi 3 muaj shtesa e miratuar). Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara (përfshi 3 muaj shtesa e miratuar).			
6	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore IPC; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Etj. si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në shumën prej 129,292,638.45 lekë pa TVSH. Gjithashtu, rezultoi se gjendja e skarpateve në një pjesë të tyre ishte problematike pasi në shumë raste realizimi i tyre nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit, pra nuk është kryer në plan të rrafshët por është kryer me diferenca të dukshme duke lënë në shumë raste edhe gjurmët e gërmimit me ekskavator apo me mjete të tjera. Në rastet kur janë hasur materiale shkëmbore, gërmimi nuk është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit. Për rrjedhojë nuk është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve duke bërë që në shumë raste kanalet të jenë me material të rrëzuar nga këto skarpate. Përveç sa më sipër u shpjegua në lidhje me skarpatat e rrugës, rezultoi se nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të kontratës pasi në pjesën më të madhe të tyre, skarpatat rezultuan të shembura dhe/ose jo të qëndrueshme, me material të shkrifët në rrugë, kanalet rezultuan të mbushur me materialin e rrëzuar nga skarpatat dhe në shumë raste masivet e gurëve me dimensione të konsiderueshme ishin në rrugë duke u bërë kështu një shkak i mundshëm për ndodhjen e aksidenteve. Grupi i Auditimit kreu verifikim të të gjithë aksit për të dy segmentet dhe situata e skarpateve dhe pjesërisht ajo e kanaleve rezultoi të ishte tejet problematike. Konkretisht, referuar	31 – 41	E lartë	1. Nga ana e FSHZH të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e vlerës 129,292,638.45 lekë pa TVSH në lidhje punët e kryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe/apo të kryera jo sipas përshkrimeve të bëra në situacionin përfundimtar, kjo përmes edhe një verifikimi më të plotë në terren¹ si dhe nxjerrjen e një konkluzioni për kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 17.04.2019 me objekt <i>‘Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 2 Segmenti Ura e Gjormit – Brataj Ura a Laskos’</i>. 2. Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P.E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të skarpateve gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit, për kryerjen e një azhomimi topografik, me qëllim saktësimin e volumeve të punimeve të kryera dhe korrigjimin (në rast të konstatimit të ndryshimeve) të volumeve të situacionit përfundimtar të zërave që preken nga këto ndryshime. 3. Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe

¹ Ky rekomandim është vendosur nisur nga pretendimet e subjektit të audituar se gjatë verifikimit në terren GA realizoi sondazhe jo për çdo km por në disa pika të rastësishme.

specifikimeve teknike Seksioni 4, pika 4.01, janë cituar ndër të tjera se: “... <i>Gërmimet dhe mbushjet e nevojshme për krijimin e trupit të rrugës, kanaleve kulluese anësore, akseset, kalimet dhe pjerrësitë dhe të tjera si këto, si edhe për ndërtimin e strukturave, duhet të bëhen në format dhe dimensionet e treguara në vizatimet përkatëse ... Duhet treguar kujdes i veçantë në dhënien formës ekzakte kanaleve kulluese, në nivelimin dhe krijimin e bankinave, në profilizimin e skarpateve dhe të anëve të rrugës ... Pjerrësitë e gërmimeve dhe mbushje duhet të kryhen sipas pjerrësisë së përshtatshme sipas natyrës dhe karakteristikave fiziko-mekanike të formacioneve dhe gjithsesi, sipas instruksioneve me shkrim të Supervizorit ... Kontraktori duhet, me shpenzimet e veta, do të bëjë të gjitha testet e nevojshme që duhet të kryhen në laboratorin e kantierit dhe të përcaktojë natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë, për të përcaktuar mundësinë e përdorimit dhe metodave që do të ndiqen në përdorim”.</i> Në fakt nga verifikimi në terren u konstatua se në shumë raste këto pjerrësi nuk përputheshin me projektin e zbatimit. Konkretisht, kjo mos përputhje qëndronte në ndryshimin e këndeve të pjerrësisë mes vizatimit dhe faktit, apo masive të pa gërmuara në skarpatë të cilat nuk krijojnë një plan të rrafshët ashtu siç edhe është paraqitur detaji i projektit mbi të cilin janë kryer edhe vëllimet e punës për pagesat e kryera ndaj kontraktorit të punimeve S. Për rrjedhojë rezultoi se nuk është treguar kujdes i veçantë në dhënien e formës ekzakte të pjerrësive dhe përveç kësaj, këto pjerrësi nuk janë kryer në përshtatje me karakteristika fiziko – mekanike të formacioneve. Në dosje nuk disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë. Për sa i takon kanaleve të betonit në shumë raste u konstatua mos respektim i detajeve të projektit, kryesisht për sa i përket formës lineare, estetike në dimensione në disa raste dhe pa respektuar as trashësinë dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të projektit. Konkretisht, nga inspektimi rezultoi se për punimet e betonit të kanaleve anësore nuk është respektuar trashësia e kanalit e parashikuar për tu kryer në masën 10 cm si dhe nuk është realizuar as përfundimi me hekur i segmentit nga PK 5+197.61 deri në PK 5+799.54. Si pasojë e mos respektimit të detajeve të projektit rezultoi se janë dëmtuar kanalet e kullimit duke u çarë dhe duke mos kryer kështu funksionin kryesor të tyre.			BOE P. E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të kanaleve anësore të betonit gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit ku u konstatua mungesa e respektimit të dimensioneve dhe materialit përforcues (hekur), për kryerjen e sondazheve shtesë me qëllim identifikimin e të gjitha rasteve të tjera ku nuk janë respektuar detajet e projektit të miratuar. Pas kryerjes së këtyre sondazheve, në rast të konstatimit të ndryshimeve nga ato të deklaruara në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të reflektohen ndryshimet në vlerë.
---	--	--	---

3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion i përputhshmërisë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së FSHZH në lidhje me Projektin “*Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës*” për periudhën nga fillimi i Projektit (2016) deri 31.12.2021 me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve.

“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të kundërt**² për devijimet nga kuadri ligjor

²**Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt:

1. Kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;** ose
2. Kur nuk është në gjendje për të marrë **dëshmi të mjaftueshme** dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

dhe rregullator në fuqi të subjektit FSHZH, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura”.

Baza për opinionin e kundërt

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*, si dhe ISSAI 30- *Kodi Etik*, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*”.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.4.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kundërt**.

Në vijim:

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave ka rezultuar një dëm ekonomik në shumën **1,307,114 lekë pa TVSH** si dhe përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën **140,760,283.45 lekë pa TVSH**;

- Zbatimi i punimeve civile të kontratës për Lotin I ka nisur pa prezencën e supervisorit sipas kontratës FIDIC duke vijuar kështu për një afat prej 10 muajsh. Gjatë kësaj periudhe kohore punimet janë ndjekur nga specialistë të FSHZH të emëruar si mbikëqyrës të përkohshëm të cilët nuk kanë kapacitetet profesionale për kontrata të tilla dhe gjatë kësaj periudhë nuk janë dokumentuar proceset e kryera (ditar punimesh, procesverbale të punimeve të maskuara etj.) për zërat e punës të parashikuara sipas grafikut fillestar të miratuar;

- Një pjesë e konsiderueshme e vumeve të punimeve, të cilat janë mirëfilli procese pune të maskuara, janë certifikuar nga supervisorin pas datës së përfundimit të punimeve, ose gati deri në pas 2.5 vitesh nga nisja e tyre;

- Palët e përfshira në zbatimin e kontratës së punimeve për Lotin I, FSHZH dhe Konsulentit nuk kanë kryer një vlerësim të objektivave të përcaktuara në marrëveshjet e financimit me qëllim vlerësimin e rezultateve të punës së deritanishme;

Përgjegjësitë e menaxhimit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Si një OJF e cila gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, FSHZH ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, me Statutin, Manualin e Procedurave, me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit me fokus rajonal, lokal dhe territorial, në interes të publikut. Objektivat e këtij institucioni janë: *a. përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore; b. përmirësimi i shërbimeve publike vendore; c. nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.* Kompetencat përshkruhen si më poshtë: *a. menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor; b. dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format: si grant, hua, garanci dhe forma të tjera për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të*

shërbimeve publike vendore; c. dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore; d. dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor; e. kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar, të: - vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000 dhe 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar.

Ne, si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 6/1, datë 18.01.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.01.2022 deri me datë 22.04.2022, në subjektin “*Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Projekti ‘Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës’*”, për periudhën nga fillimi i Projektit (2016) deri më 31.12.2021, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë” me përbërje:

J.H., Përgjegjës Grupi

A.T., Auditues

E.S., Auditues

A.R., Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Objekti kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të Marrëveshjeve Financiare si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të zbatimit të Projektit. Auditimi ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet si dhe nëse janë arritur apo jo objektivat e Projektit. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim ***promovimin e përgjegjshmërisë*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara nga Projekti duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Struktura brenda FSHZH^{së}, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit objekt auditimi, janë si më poshtë:

➤ DEPARTAMENTIN I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE;

- NJESITË E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE/PROGRAMEVE;

▪ *Njësia e Menaxhimit të Projekteve/Programeve të Ndërhyrjeve të Infrastrukturës Rrugore që përfshin Programet e rrugëve lidhëse rajonale, të financuara nga BERZH dhe Banka Botërore, Projekti i Rrugës së Lumit të Vlorës financiar nga Fondi Kuvajtian dhe Fondi Saudit si dhe çdo program/projekt të kësaj fushe, me zbatimin e të cilit do të ngarkohet FSHZH.*

➤ DEPARTAMENTI I FINANCËS;

➤ DEPARTAMENTI JURIDIK DHE I PROKURIMIT.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje financimi, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);

- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 50/2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”; Marrëveshja e huas sipas Ligjit nr. 100/2017 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”; VKM nr. 178 datë 26.02.2020 “Për miratimin e Marrëveshjes Ndryshuese, me Shkëmbim Letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit, për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 50/2016”; Marrëveshja e huas sipas Ligjit nr. 47/2020 “Për ratifikimin e Marrëveshjes për një Hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Ligji nr. 43/2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Manualin e Procedurave të Fondin Shqiptar të Zhvillimit; etj.

7. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

☐ **ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

- **ISSAI (400)** “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- **ISSAI (4000)** “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t;
- INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve.

8. Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit të auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga Audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Marrëveshjet e Financimit: Nisur nga fakti se në total për financimin e Projektit “*Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorë*”, janë lidhur me donatorët:

- Dy marrëveshje me *Fondin e Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab*;
- Një marrëveshje me *Fondin Saudit për Zhvillim*;

dhe se nga këto marrëveshje rezultojnë të jenë amenduar me VKM nr. 178 datë 26.02.2020 marrëveshja e parë e lidhur me Fondin e Kuvajtit u verifikua nëse në këto marrëveshje janë respektuar kushtet e përcaktuara në to dhe nëse amendimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 43/2016 “*Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë*”.

Objektivat e marrëveshjeve: Duke patur në konsideratë faktin se të dyja marrëveshjet e mësipërme dhe amendimi i vetëm i kryer për marrëveshjen me Fondin Kuvajtian kanë parashikuar të njëjtat objektiva u verifikua i gjithë dokumentacioni raportues i Departamentit të Menaxhimit të Projektit dhe atij të hartuar nga Konsulenti për Lotet I, II dhe III.

Mbi menaxhimin Financiar: Në lidhje me menaxhimin financiar të Projektit u audituan praktikatat e ndjekura në zbatim të marrëveshjes së lidhur me Fondin Kuvajtian mbi mbulimin me financim nga ana e tyre dhe pjesën takuese nga qeveria shqiptare (përqindjen sipas marrëveshjes + TVSH), pagesat mbi normat e interesit të kredisë si dhe dokumentacioni raportues në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe regjistrimet në sistemin kontabël mbi pagesat e konfirmuara nga Donatori dhe nga dega e Thesarit sipas përqindjeve dhe kategorisë të shpenzimit të përcaktuar në marrëveshje.

Mbi auditimin e zbatimit të kontratave: Për periudhën objekt auditimi rezultuan të lidhura në total 3 kontrata për zbatim punimesh ndërtimi:

- Kontratë punimesh civile për Lotin I lidhur mes BOE “A.T.” me të cilin është lidhur kontrata me në datë 24.02.2017 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt “*Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm*” me vlerë të kontratës 2,002,817,718 lekë me TVSh;
- Kontratë punimesh civile për Lotin II lidhur mes BOE “S.” me të cilin është lidhur kontrata me në datë 17.04.2019 mes këtij OE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt “*Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos*” me vlerë të kontratës 4,236,665,117 lekë me TVSh;
- Kontratë punimesh civile për Lotin III lidhur mes OE “I.” me të cilin është lidhur kontrata me në datë 24.02.2017 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt “*Ura e Laskos – Qeparo dhe Ura e Laskos – Rruga e lidhjes me Kuçin*” me vlerë të kontratës 3,540,036,147 lekë me TVSh;
- Kontratë konsulence për Lotin I, II dhe III me vlerë të kontratës 2,173,178 euro me TVSh;
- Kontratë konsulence për Lotin IV me vlerë të kontratës 2,294,544 USD me TVSh;

Nga këto, kontrata për Lotin e III e lidhur me datë 08.05.2020, rezulton ende në proces. Në zbatim të Programit të Auditimit u auditua zbatimi i kontratave të punimeve për Lotin I dhe Lotin II mbështetur në dokumentacionin e ndodhur në dosjen teknike të dorëzuar nga Konsulenti (Supervizori i punimeve), si p.sh:

Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Praktikatat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order); Korrespondencat mes FSHZH, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Fondin Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik (FKZHE).

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

FSHZH është një OJF e cila gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, *“Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”*, me Statutin, Manualin e Procedurave, me kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e financimit dhe të zbatimit të projekteve si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit me fokus rajonal, lokal dhe territorial, në interes të publikut. Objektivat e këtij institucioni janë:

a. përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore;

b. përmirësimi i shërbimeve publike vendore;

c. nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Kompetencat përshkruhen si më poshtë:

a. menaxhimi i projekteve të financuara nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm që kanë si qëllim zhvillimin rajonal dhe vendor;

b. dhënia e mbështetjes financiare në të gjitha format: si grant, hua, garanci dhe forma të tjera për njësitë e pushtetit vendor, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

c. dhënia e mbështetjes teknike për zbatimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e investimeve, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike dhe të shërbimeve publike vendore;

d. dhënia e asistencës teknike dhe kryerja e trajnimeve, për rritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor;

e. kryerja e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor.

1. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se në total për financimin e Projektit *“Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”*, janë lidhur marrëveshje financiare mes Ministrisë Financave dhe Ekonomisë me donatorët të cilat janë ratifikuar respektivisht me ligjet:

A. Dy marrëveshje me Fondin e Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab;

1. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 50/2016, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”*;

2. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 47/2020, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes për një Hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”*;

B. Një marrëveshje me Fondin Saudit për Zhvillim;

1. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 100/2017, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”*;

Nga këto marrëveshje rezulton të jetë amenduar me VKM nr. 178, datë 26.02.2020 marrëveshja e ratifikuar më parë sipas Ligjit nr. 50/2016, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”* dhe është në fazë amendimi edhe Marrëveshja me Fondin Saudit. Të dhënat në lidhje me vlerat e mbuluara nga

donatorët sipas marrëveshjeve përkatëse dhe pjesën takuese të marrë përsipër nga Qeveria Shqiptare jepen sipas Aneksit 1.1.1.

1. Titulli i gjetjes:

Situata:

Miratim i ndryshimit të marrëveshjes jashtë afatit të marrëveshjes bazë.

Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 50/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës” ka parashikuar përfundimin e Projektit me datë 31.12.2019, përfundimin e afatit të disbursimit me datë 31.12.2020 si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 2

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	Ndërtimi i punimeve civile	9,913,000	77 %
2	Shërbime Konsulence	777,000	100 %
3	Kontigjenca të pa alokuara	1,310,000	
	TOTAL	12,000,000	

Në lidhje me sa më sipër duhet theksuar fakti se termi ‘Projekt’ i referohet pjesës koresponduese të punimeve dhe konsulencës që mund të realizohet me këtë shumë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/1 prot., datë 25.02.2019 është bërë kërkesë për rialokimin e fondeve nga kategoria Kontigjenca të pa alokuara në shumën 1,310,000 KD në llogari të kategorisë Ndërtimi i punimeve civile, shtyrjes së datës së përfundimit të punimeve deri me datë 31.12.2021 si dhe zgjatjen e afatit të disbursimit të fondeve të Projektit deri me datë 31.12.2022. Konkretisht është kërkuar të miratohet kalimi i fondeve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 3

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	Ndërtimi i punimeve civile	11,223,000	77 %
2	Shërbime Konsulence	777,000	100 %
3	Kontigjenca të pa alokuara	0	0
	TOTAL	12,000,000	

Me shkresën nr. 4344/1 prot., datë 27.03.2019, administruar në FSHZH me shkresën me nr. 438/1 prot., datë 29.03.2019, është dërguar nga ana e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj, Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve, shkresa me lëndë Mbi kredinë e Fondit të Kuvajtit për financimin e Projektit të rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës. Sipas kësaj shkrese MFE ka njoftuar FSHZH për miratimin e rialokimit të fondeve dhe për faktin se Fondi Kuvajtian nuk ka shprehur ndonjë kundërshti në lidhje me shtyrjen e afateve si dhe për faktin se kanë qenë duke u vijuar komunikimet me Fondin Kuvajtian me qëllim formalizimin e ndryshimeve të kërkuara nëpërmjet një dokumenti ndryshues. Në fakt, referuar këtij dokumenti të datës 26.03.2019 bashkëlidhur rezulton se nga ana e Fondit Kuvajtian është dhënë

	miratimi për rialokimin e fondeve si dhe për zgjatjen e afatit të disbursimit por <u>nuk është shprehur mendim në lidhje me zgjatjen e afatit të realizimit Projektit</u>. Pas një kërkesë të Fondit Kuvajtian në lidhje me një dokument amendimi të propozuar nga pala shqiptare, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/4 prot., datë 03.07.2019 është dërguar në FSHZH për mendim draft dokumenti ndryshues i Marrëveshjes së Huas duke përfshirë në këtë draft ndryshimet në lidhje me: - Rialokimin e fondeve të kontigjencës; - Shtyrjen e afatit të përfundimit të Projektit deri më datë 31.12.2021; - Shtyrjen e afatit të disbursimit deri më 31.12.2022; Në rrugë elektronike i është dërguar Fondit Kuvajtian më datë 16.07.2019 Drafti i ndryshimit të Marrëveshjes së Huas si më sipër nga ana e të cilit është kthyer përgjigje me datë 05.09.2019 duke miratuar këtë Draft. Me shkresën e administruar në MFE me nr. 19184/5prot., datë 28.01.2020 është njoftuar Fondi Kuvajtian në lidhje me Miratimin në Parim të Marrëveshjes Ndryshuese të Marrëveshjes së Huas dhe me pas kjo është miratuar me VKM nr. 178, datë 26.02.2020 “Për miratimin e Marrëveshjes Ndryshuese, me Shkëmbim Letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit, për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 50/2016”. Nga sa më sipër rezulton se miratimi me VKM i shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve është kryer përtej afatit në të cilin punimet duhet të kishin përfunduar, kjo pavarësisht miratimit me shkëmbim letrash mes palëve.
Kriteri:	Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 50/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, Shtojca 2 Përshkrimi i Projektit si dhe Ligji nr. 43/2016, “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 Ndryshimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.
Ndikimi:	Përgjatë periudhës 31.12.2019 – 25.02.2020 projekti është zbatuar në kundërshtim me Marrëveshjen e Financimit.
Shkaku	Miratimi me vonesë i ndryshimit të Marrëveshjes së Financimit.
Rëndësia:	E ulët.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH, në cilësinë e Njësinë Zbatuese të Projektit, të merren masa për të intensifikuar përpjekjet për miratimin në kohë dhe brenda afateve të parashikuara të ndryshimeve të kushteve të marrëveshjeve të financimit si dhe njoftimin e MFE për rastet kur marrëveshjet janë në kushtet e zbatimit të tyre jashtë afateve të miratuar në marrëveshjet përkatëse.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Pretendimi i subjektit:

“FSHZH ka iniciuar kërkesën zyrtare me nr. 2455/1 prot., datë 25.02.2019 për ndryshimin përkatës të marrëveshjes, pra rialokimin e zërave ndërmjet kategorive, shtyrjen e afatit të projektit 31.12.2021 dhe të disbursimit të fondeve 31.12.2022”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2.2 Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësin.

Projekti “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” është financiar nga Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab, nënshkruar në datën 30.03.2016 dhe ratifikuar me ligjin nr. 50/2016 në Kuvendin e Shqipërisë në datën 05.05.2016. Punimet për rehabilitimin e rrugës kanë përfshirë dy kategori kryesore si më poshtë:

Punimet civile: Përmasimin e gjeometrisë së rrugës ekzistuese, zgjerimin dhe shtrimin e saj, rikonstruksionin e urave ekzistuese dhe ndërtimi i urave të reja, strukturat e vogla tombino, mure mbajtëse dhe mbështetëse, kanale drenazhi etj.

Punimet për infrastrukturën urbane: Kalimin e këmbësorëve, zona të parkimit, ndriçimin elektrik (spostime linjash të TM dhe TU), kabëll optik, shenjat e trafikut etj.

Punimet janë kryer sipas loteve të projektit si më poshtë:

Lot 1: Punimet për rehabilitimin e rrugës Bypass Vlora-Peshkëpi-Gjorm CWC/ICB/2016/1 kanë filluar në datë 30 Mars 2017 dhe kanë përfunduar me datë 26.11.2019, data e lëshimit të TOC (Certifikata e Përfundimit të Punimeve). Vlera përfundimtare e kontratës 1,669,014,765 lekë pa TVSH, e cila nuk kalon vlerën e kontratës. Nga rehabilitimi, është përmirësuar gjeometria e rrugës në një trase me 7 m gjerësi (2 x 3.5 m) dhe bankina në të dy anët e saj me gjerësi 0.75 m, shtresa e nën-bazës 2 x 20 cm, shtresa bazës 20 cm, shtresa bituminoze 8 cm, shtresa lidhëse 5 cm, dhe shtresa asfaltit 4 cm. Gjithashtu, u ndërtuan 2 ura të reja, në km 12 dhe km 17, u zëvendësuan dy ura me tombino çeliku, gjithashtu u ndërtuan mure mbajtës, tombino betoni, kanale drenazhimi prej betoni në zonat e caktuara, mbrojtje të shpateve nga rrëshqitja e dheut, shtrimi në gjatësinë e rrugës të kablove optik, punime gjelbërimi, shenja të trafikut, etj.

Lot 2: Punimet sipas kontratës CWC/ICB/2017/2 Lot 2 me objekt Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos kanë filluar në datë 13.05.2019 dhe kanë përfunduar në datë 09.09.2021, data në të cilën është lëshuar edhe Certifikata e Përfundimit të Punimeve (TOC) dhe objekti është tërësisht operacional. Kontrata është realizuar në vlerën përfundimtare 3,530,554,264 lekë pa TVSH, e cila nuk kalon vlerën e parashikuar të saj. Rruga është përmirësuar me zgjerimin e rrugës ekzistuese në 7 m (2 x 3.5 m), 0.75 m bankina në të dy anët e saj. Në punimet e shtrimit të rrugës përbërja e shtresave të trupit të rrugës në përputhje me specifikimet teknike nën-baza 2 x 20 cm, baza 25 cm, shtresa ngjitëse 6 cm, si dhe asfalti 4 cm. Gjatë punimeve konstruktive janë përfshirë 7 ura, tombino çeliku, gjithashtu, janë ndërtuar mure mbajtës, tombino betoni, kanale drenazhimi prej betoni, mbrojtje shpatesh, punime gjelbërimi, shenja të trafikut, etj.

Kontrata e sipërcituar është në periudhën e përgjegjësisë së defekteve.

Lot 3: Punimet për rehabilitimin e rrugës Ura Laskos-Qeparo dhe Ura Laskos-Kuç CWC/ICB/2018/3, kanë filluar në datë 08.05.2020 dhe është në proces ndërtimi. Punimet e rrugës konsistojnë në zgjerimin e rrugës ekzistuese në 7 m (2 x 3.5 m), 0.75 m bankina në të dy anët e saj. Në punimet e shtrimit të rrugës përbërja e shtresave të trupit të rrugës do të jetë në përputhje me specifikimet teknike nën-baza 2 x 20 cm, baza 15 cm, shtresa ngjitëse 6 cm, si dhe asfalti 4 cm. Në punimet konstruktive janë përfshirë 4 ura, mure mbajtës, tombino betoni, kanale drenazhimi prej betoni, mbrojtje shpatesh, punime gjelbërimi, shenja të trafikut, etj.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk janë vlerësuar objektivat social-ekonomike që gjeneron projekti.
Situata:	Në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab, datë 30.03.2016, është përcaktuar se komponentët kryesore të projektit do të jenë si më poshtë: 1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës; 2. Shtrimi i sipërfaqes;

	3. Rehabilitimi i kullimit, duke përfshirë ura, tombino, mure mbajtës, gjithashtu siguria dhe ndriçimi, etj. 4. Shërbimi i konsulencës. Gjithashtu, objektivi kryesor i projektit është përcaktuar realizimi i punimeve në përputhje me standardet e pranuar dhe qëndrueshmëria e infrastrukturës publike, në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale. Në zbatim të kërkesave Shtojca 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, është lidhur Kontrata e Shërbimit të Konsulencës për projektin “<i>Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës</i>”, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit “J.E.” në datë 18.01.2018. Në Shtojcën A, pika II Objektivat, të kontratës së sipërcituar (ToR) është përcaktuar se projekti do të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të përfitimeve social-ekonomike dhe ambientale si më poshtë: -<i>Mundësinë e hyrjes në rrugën e përmirësuar;</i> -<i>Mundësi më e madhe për lidhjen me tregjet rajonale dhe lokale për tregtimin e produkteve lokale, përmirësimin e ndëreveprimit social;</i> -<i>Uljen e papunësisë nëpërmjet krijimit të punëve të reja dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese;</i> -<i>Diversifikimin e ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve të turizmit;</i> -<i>Bashkëveprimin social të përmirësuar dhe rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive;</i> -<i>Pakësimin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, etj.</i> Nga auditimi, nuk rezulton vlerësimi i këtyre objektiveve. Në pikën 2, Shtojca B “<i>Kërkesa Raportuese</i>” të Kontratës Konsulencës është përcaktuar se Raporti Fillestar do të përshkruaj planin që Konsulenca ka vendosur lidhur me detyrat e saj, si edhe stafin, gjithashtu edhe vërejtjet siç ajo i gjykon. Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të komentojë këtë Raport. Gjithashtu, në seksionin VI, Shtojca A, të Kontratës së Konsulentit, është përcaktuar Raporti Fillestar (Inception Report) i konsulentit me elementet kryesore përbërës, dhe që përfshin <i>synimet dhe objektivat</i> e projektit, gjithashtu <i>Manualin e Kontrollit të Cilësisë</i> bashkëlidhur, por që nga auditimi nuk rezulton që FZSHH ka administruar një raport të tillë. Në Kontratën e Punës, Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, paragrafi i shtuar i nën-pikës 34.1, në pjesën e parë të paragrafit është përcaktuar që për aq sa është e mundur Kontraktori duhet të punësojë punëtorë lokal. Nga auditimi, nga ana e Klientit nuk është provuar me të dhëna zyrtare se Kontraktori ka respektuar kriterin e mësipërm. Në seksionin II, Shtojca A, “<i>Përshkrimi i Projektit</i>” të Kontratës së Konsulentit është përcaktuar se ndërtimi i infrastrukturës urbane përbëhet nga trotualet, zonat e parkimit, ndriçimi publik, vendosja e kabllit optik, instalimi i sinjalistikës rrugore, etj. Nga raportet e konsulentit nuk rezulton të jetë raportuar në mënyrë të veçantë për infrastrukturën urbane, gjithashtu mbi realizimin e hyrjeve-daljeve të fshatrave të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës, për pasojë nuk rezulton e qartë edhe mënyra dhe përgjegjësia e realizimit të tyre. Nga raporti teknik i projekt-zbatimit, vetëm për Lot 1 p.sh. janë përcaktuar rreth 60 hyrje – dalje të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës. Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka lidhur marrëveshjet e investimit me bashkitë përkatëse, respektivisht me Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Selenicë
--	---

	datë 26.01.2017, si edhe me Bashkinë Himarë datë 21.03.2017. Në nenin 3 të marrëveshjeve të sipërcituara, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të janë të angazhuara, midis të tjerave me detyrimin, që të japë informacione dhe të dhëna në kuadër të kësaj marrëveshje, përfshirë të dhëna të mbledhura nga përfituesit dhe të dhëna shtesë të kërkuara nga FSHZH apo Supervizori. Gjithashtu, në nenin 5 “Për realizimin e punimeve” të Marrëveshjeve të Investimit është përcaktuar se me përfundimin e punimeve, për çdo prej kontratave të punimeve, gjatë inspektimeve të tyre duhet të marrin pjesë, dhe për pasojë duhet të firmosin edhe Certifikatat e Përfundimit të Punimeve bashkitë respektive, gjë që nga dy lotet e para kjo gjë nuk rezulton të ketë ndodhur. Sa sipër, duke qenë se pronari i rrugës që rehabilitohet është Autoriteti Shqiptar Rrugor, kontratat e mësipërme nuk kanë krijuar mundësi për funksionimin e duhur midis aktorëve të projektit dhe për këtë arsye ato duhet të përmirësohen. Veprimet dhe mosveprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë mungesën e vlerësimit të objektivave të projektit “Rehabilitimi i rrugës të Lumit të Vlorës”.
Kriteri:	Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, nën-pika 34.1, të kontratës së punimeve, ku përcaktohet se: <i>Për aq sa punëtorja e përshtatshme lokale është e mundur Kontraktori duhet të punësojë të tillë punëtori.</i> Kapitulli IV Shtojca, Aneksi A, seksionet II dhe VI, e Kontratës për Shërbimin e Konsulencës “Për rehabilitimin e rrugës së Lumit të Vlorës”, ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe J “P.” & “E.”, datë 18.01.2018, ku përcaktohet se: II. Objektivat <i>Projekti do të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të përfitimeve social ekonomike dhe ambientale si për shembull:</i> - <i>Mundësinë e hyrjes në rrugën e përmirësuar;</i> - <i>Mundësi më e madhe për lidhjen me tregjet rajonale dhe lokale për tregtimin e produkteve lokale, përmirësimin e ndërveprimit social;</i> - <i>Uljen e papunësisë nëpërmjet krijimit të punëve të reja dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese;</i> - <i>Diversifikimin e ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve të turizmit;</i> - <i>Bashkëveprimin social të përmirësuar dhe rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive;</i> - <i>Pakësimin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, etj.</i> VI. Raportet duhet të mbulojnë informacionet si më poshtë: <i>Raporti fillestar;</i> - <i>Synimet e projektit dhe objektivat;</i> Kërkesat e Shtojcës 2, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, ku përcaktohet se: <i>“Objektivi kryesor i projektit është përcaktuar realizimi i punimeve në përputhje me standardet e pranuar dhe qëndrueshmëria e infrastrukturës publike, në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale”.</i>
Ndikimi:	Rreziku i qëndrueshmërisë së infrastrukturës urbane.
Shkaku	Nuk vlerësohen objektivat e vendosura.

Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, nëpërmjet Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, si edhe Njësisë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të marrë masa për vlerësimin aktual të objektivave të matshëm për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” deri në përfundimin e projektit me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë të infrastrukturës urbane dhe përfundimin me sukses të rehabilitimit të rrugës të Lumit të Vlorës.
1.2 Rekomandimi:	Drejtori Ekzekutiv i FSHZH të marrë masa për ndryshimet përkatëse të marrëveshjeve të investimeve me bashkitë, për të përcaktuar kërkesa dhe përgjegjësi të qarta vendimmarrjen nga ana NjVV për pjesë e tyre të territorit, ashtu edhe për pjesëmarrjen e tyre si aktorë në realizimin e projektit.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Pretendimi i subjektit:

“Referuar kontratës së Mbikëqyrjes në Aneksin A, Termat e Referencës (ToR), Seksioni II, përcaktohen objektivat të cilat ka projekti dhe jo detyrat e konsulentit, pra nuk ngarkon konsulentin të bëjë monitorimin e tyre”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2.3 Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Me Ligjin nr. 50/2016, është lidhur marrëveshja e huas midis Qeverisë Shqiptare dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës” me vlerë financimi 12,000,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,828,677,230 lekë), financim i cili mbulon Lot I, II dhe III. Me Ligjin nr. 47/2020, është ratifikuar marrëveshja e huas për një shtesë në Projektin “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës” ku vlera e financimit e shtuar është 6,800,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 37,591,481 lekë). Për sa më sipër financimi nga Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab për Projektin shkon me një vlerë totale prej 18,800,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,866,268,711 lekë). - Me Ligjin nr. 100/2017, është lidhur marrëveshja e huas midis Qeverisë Shqiptare dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e Projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, me vlerë financimi 112,500,000 rial audit (afërsisht 3,446,700,000 lekë), financim i cili është parashikuar për Lot IV. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kjo marrëveshje nuk është bërë ende efektive. Nga Qeveria Shqiptare do të mbulohet me financim diferenca në masën 23% për kategorinë “Ndërtimi i punimeve civile” dhe pagesat e TVSh^{së} për kategoritë “Ndërtimi i punimeve civile dhe Shërbimet e konsulencës”. Financimi i nga Fondi Kuvajtian mbulon 3 Lotet e Projektit, ku deri në momentin e auditimit ka përfunduar Lot I i cili është në periudhë garancie, si dhe janë në fazën e zbatimit të punimeve Lot II dhe Lot III. Deri në momentin e auditimit, nga Fondi Kuvajtian janë disbursuar në total, në masën 77% për kontratat e sipërmarrjes së punimeve dhe në masën 100% kontratën e supervizionimit konsulencë shumë 1,920,987,273.89 lekë dhe 3,074,292.99 Euro, si dhe janë disbursuar nga Qeveria Shqiptare për kontratat e sipërmarrjes së punimeve në masën 23% shumë 706,584,698 lekë dhe TVSh në shumë 692,722,763.4 lekë për kontratat e sipërpërmendura. Ky Projekt rezulton të jetë financiar si më poshtë:

Tabela nr. 4

Sipërmarrje punime	Vlera e kontratave me TVSh, në Lekë	Fatura tatimore me TVSh, në Lekë	Kosto lokale 23%	TVSh 20%, në Lekë	Disbursimi 77%, në Lekë	Disbursimi 77%, në Euro
Lot I	2,002,817,718.47	2,002,813,518.01	364,678,959	333,802,252	1,003,498,641.26	1,598,992.99 (217,383,098.51 Lekë)
Lot II	4,236,665,117	1,564,300,625.88	274,055,047	260,698,768	917,488,632.63	-
Lot III	3,540,036,718	354,003,614.76	67,850,692	59,000,602	-	-
Totali	9,779,519,553.47	3,921,117,758.65	706,584,698	653,501,622	1,920,987,273.89	1,598,992.99 (217,383,098.51 Lekë)
Konsulencë	Vlera e kontratës me TVSh, në Euro	Fatura tatimore me TVSh, në Euro	Kosto lokale	TVSh 20%, në Euro	Disbursimi 100%, në Lekë	Disbursimi 100%, në Euro
Totali	2,173,178.21	1,892,480 (235,272,852.2 Lekë)	-	315,380 (39,221,141.4 Lekë)	-	1,475,300

Tabela nr. 5 Tabela e disbursimeve e ndarë sipas viteve

Data	Disbursimet në Lekë	Disbursimet në Euro	Pa disbursuar në Lekë	Pa disbursuar në Euro	Interesi i paguar Dinarë Kuvajtian
31.12.2017	-	-	-	-	-
31.12.2018	670,721,717.46	698,000	-	-	6,509.87
31.12.2019	912,303,606.27	2,433,792.99	-	-	68,099.21
14.08.2020	337,961,950.16	205,700	227,152,319.47	101,600	66,348.97
Totali	1,920,987,273.89	3,337,492.99	227,152,319.47	101,600	140,958.04

Pagesa e principalit e shprehur në dinarë kuvajtian është e parashikuar të paguhet në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste në shumën 315,700 KD për secilin këst dhe 2 (dy) këste në shumën 317,400 KD për secilin këst, ku totali shkon në shumën 12,000,000 milionë dinarë kuvajtian sipas kushteve të parashikuara në marrëveshje. I pari prej këtyre kësteve do të jetë i pagueshëm në datën e parë në të cilën çdo interes apo pagesat e tjera të kredisë do të bëhen të pagueshme, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas, pas kalimit të një periudhe pa pagesë pricipali prej 5 (pesë) vitesh, duke filluar nga data në të cilën Fondi paguan ndonjë shumë nga huaja sipas aplikimit të parë për tërheqje të kryer nga Huamarrësi ose nga data kur Fondi lëshon një sipërmarrje në pajtim me seksionin 3.02 të Marrëveshjes së Huas, në rast se aplikimi i tërheqjes së parë kërkon lëshimin e një sipërmarrje të tillë, cilado që është më herët nga dy datat.

1. Titulli i gjetjes:	Pagesa të kryera jashtë afateve të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve.
Situata:	Referuar pjesës së financimit të Kredisë nr. 943, për Projektin për sa i përket kontratave të sipërmarrjeve të punimeve për Lot I dhe Lot II është konstatuar se në pesë raste disbursimet e IPC ^{ve} nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në klauzolën nr. 60.11 të kontratave. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se janë hasur vonesa në disbursimin e IPC ^{ve} për pjesën takuese prej 77 % të mbuluar Fondi Kuvajtian. Nga këto 5 raste, në 2 prej tyre, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 889 prot., datë 07.06.2019, nga ana e Kontraktorit për LOT 1 “A M”, janë paraqitur ankesa (Claim) për IPC ^{të} 5 dhe 6. Në vijim të korrespondencave mes Fondit Kuvajtian, FSHZH, Kontraktorit dhe Supervizorit është dakordësuar mes palëve tërheqja për ankesën me datë 03.07.2019 në takimin e muajit.
Kriteri:	Klauzola 60.11, e Kontratave të Sipërmarrjes së Punimeve për Lot I dhe Lot II <u>ku përcaktohet se:</u> “Vlera që i detyrohet kontraktorit sipas pagesave të ndërmjetme për IPC-të të lëshuara nga supervizori/inxhinieri, referuar kësaj klauzole ose të ndonjë termi tjetër të kontratës subjekti i klauzolës 47, do të paguhet

	<i>nga punëdhënësi brenda 49 ditëve nga data e që IPC është marrë nga punëdhënësi” referuar klauzolës së ndryshuar 60.11.</i>
Ndikimi:	Ekspozim ndaj riskut për penaltite nga ana e Kontraktorëve.
Shkaku	Vonesat në pagesat në masën 77 % për IPC nga Fondi Kuvajtian.
Rëndësia:	E lartë.
1. Rekomandimi:	1 Nga FSHZH, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Përgjegjësi i Njesisë së Projektit të merren masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse duke shmangur të gjitha praktikatat penguese në disponibilitetin e fondeve në mënyrë që procesi i pagesave të IPC ^{-ve} të realizohet brenda afateve të përcaktuar në kontratë duke eliminuar mundësitë për penaltite (<i>Claim</i>) nga kontraktorët.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Pretendimi i subjektit:

“Lidhur me gjetjen nga ana Juaj për sa i përket vonesave me disbursimet referuar pjesës së financimit të kredisë nr. 943, për kontrata të punimeve për Lot I dhe Lot II sqarojmë se nga ana e FSHZH – së ka pasur komunikime të vazhdueshme lidhur me mos procedimin e pagesave në kohën e duhur ...”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2. Titulli i gjetjes:	Mos-parashikim i mënyrës së lëvrimit të huas në llogari të përfituesit në Marrëveshjen e Financimit.
Situata:	Në Marrëveshjen Financiare të ratifikuar me ligjin nr. 50/2016 datë 5.5.2016 me vlerë financimi 12,000,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,828,677,230 lekë) konstatohet se, nuk është parashikuar mënyra e lëvrimit të shumave të huas nga Fondi Kuvajtian. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky lëvrim është kryer si më poshtë: Pas marrjes së aplikimit nga FSHZH, Fondi Kuvajtian urdhëron Bankën Kombëtare të Kuvajtit për disbursimin e shumave të aplikuara dhe në këtë moment njoftohet edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë me anë të dokumentit <i>Debit Advice</i> për urdhër transfertën; Nga B. K. K shuma lëvrohet në një llogari në B.N.Y në S; Kjo shumë kalon më pas nga B.N.Y në llogari të kontraktorit apo konsulentit, sipas rastit. Mos parashikimi i procedurës dhe afatit të nevojshëm për lëvrimin e fondeve deri në llogarinë e përfituesit final si dhe kalimi i pagesave në hallkat e mësipërme ka sjellë si rezultat vonesa në disbursimin e pagesave pjesore (IPC), duke mos u respektuar afatet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve dhe asaj të konsulencës e duke e ekspozuar FSHZH si implementues të Projektit ndaj riskut për penaltite nga ana e Kontraktorëve (<i>Claim</i>).
Kriteri:	VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, pika 18 <u>ku përcaktohet se</u> : “ <i>Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grandet do të regjistrohen si të hyra në "Llogarinë qendrore të thesarit", në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grandet që lëvrohen në natyrë, për shkak</i>

	<i>se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuresi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave’.</i>
Ndikimi:	Ekspozim i FSHZH ndaj riskut për penalitete nga ana e Kontraktorëve për ankesa nga vonesat në kryerjen e pagesave.
Shkaku	Mos parashikimi në Marrëveshjen Financiare të procedurës së lëvrimit të shumave të huas me qëllim llogaritjen e afatit të nevojshëm për kryerjen e pagesave.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që, në fazën e negociimeve me donatorët, draft - Marrëveshjet Financiare të përfshijnë edhe mënyrën e lëvrimit të shumave të huas në llogari të përfituesit final.
2.2 Rekomandimi:	Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që gjatë lidhjes së kontratave të cilat financohen nga donator të huaj në afatet e pagesave të parashikuara në to, të përfshihen edhe afatet të cilat i duhen donatorit për të kryer disburimin final për pjesën takuese, duke shmangur penalitetet e mundshme.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Pretendimi i subjektit:

“Projekti i rehabilitimit të rrugës së lumit të Vlorës do të financohet me huanë e marrë nga Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab ...”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shitesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2.4 Mbi prokurimin e fondeve të kredisë si dhe ndjekjen e procedurave të Vlerësimit dhe Kontraktimit.

2.4.1 “Loti I - Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm”

Tabela nr. 6

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Segmenti By-pass i Vlorës-Peshkëpi-Gjorm. Lot I.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 47 datë 13.04.2016	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit 1. V. K. 2. O. Sh. 3. A. Z.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave 1. S. K. 2. T. B. 3. L. M. 4. M. Dh. 5. E. O.
2. Procedura e Prokurimit Tender i Hapur Ndërkombëtar ICB, post kualifikim sipas Udhëzuesit për prokurimet publikuar në vitin 2001.		
5. Vlera sipas Projektit (pa TVSH) 2,881,257,885 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 1,669,014,765 lekë	7. Diferenca me vlerën e Projektit (pa TVSH) 1,21,243,120 lekë.
8. Data e hapjes së tenderit: 09.05.2016, ora 14:00.	9. Burimi Financimit Fondi Kuvajtian, Fondi Saudit dhe Qeveria Shqiptare.	10. Operatorët Ekonomikë a) Aplikuar 33 Operatorë b) S’kualifikuar 27 Operatorë c) Parakualifikuar 6 operatorë d) Pjesëmarrës në tender 5 operatorë. e) Kualifikuar 1 operator.

b. Zbatimi i Kontratës		
11. Lidhja e kontratës A. – T., 24.02.2017.	12. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,002,817,718.47 lekë.	13. Likuiduar plotësisht.

Nga auditimi i dosjes së prokurimit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Kërkesa nga FSHZH drejtuar donatorëve për “No Objection” është bërë me e-mailin e datës 01.04.2016, ora 10:45.

- Me fax në datën 12.04.2016, ka ardhur përgjigja nga Fondi Kuvajtian për dakordësinë e tyre lidhur me DST të procedurës së prokurimit.

- Kërkesa për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, aksi Selenicë-Kuç-Qeparo*” Segmenti “*Bypass-i i Vlorës-Peshkëpi-Gjorm*”, është hartuar nga T. B. me detyrë Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës pranë FSHZH dhe i është drejtuar Njësisë Juridike dhe Prokurimit të FSHZH.

- Urdhri i prokurimit është me nr. 47 dhe datë 13.04.2016. Fondi limit është 3,457,509,462 lekë me TVSH.

-Nga dokumentacioni i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit u konstatuan dy amendamente për shtyrjen e datës së hapjes së tenderit. Konkretisht amendamenti nr. 1 i cili shtyn datën e hapjes nga data 09.05.2022 që ishte parashikuar në datën 27.05.2022 dhe amendamenti nr. 2 i cili ndryshon datën e hapjes nga data 27.5.2022 në datën 03.06.2022 ora 10:00.

-Kanë aplikuar për DST 33 operatorë ekonomikë. Nga këta vetëm dy janë paraqitur me përfaqësuesit e tyre në datën e hapjes së ofertave 03.06.2016, në orën 10:00.

-Me fax në datën 06.10.2016, Donatori propozon tek titullari i FSHZH një ndryshim në DST lidhur me paragrafin 30.3.

-Raporti i parakualifikimit është miratuar në datën 10.10.2016. Nga vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë, kanë rezultuar:

a) Tre operatorë ekonomikë të parakualifikuar pa asnjë mangësi dhe konkretisht “E.”, “R.” dhe “J.” & “C.”.

b) Tre operatorë ekonomikë të parakualifikuar por me devijime të vogla dhe konkretisht “O.”, “I.” dhe “A.”.

c) Të skualifikuar me mangësi të theksuara në ofertat e tyre, janë 27 operatorë ekonomikë.

-Ftesa për të marrë pjesë në tender është bërë në datën 02.11.2016 nga specialisti i prokurimeve të FSHZH A. Z. tek 6 operatorët e parakualifikuar. Nga donatori, dakordësia është dhënë në datën 30.10.2016 me fax. Po në të njëjtën datë 02.11.2016, janë njoftuar të gjithë pjesëmarrësit në tender lidhur me rezultatet e vlerësimit paraprak të ofertave të ardhura në FSHZH.

-Në datën 20.12.2016, janë paraqitur për të dhënë ofertën e tyre, katër operatorë ekonomikë dhe konkretisht “J.” & “C.”, “A.”, “R.” dhe “S.” të përfaqësuar nga përfaqësuesit e tyre të cilët kanë nënshkruar në formularin përkatës të hapjes së procesit të tenderit. Të pestë operatorët ekonomikë kanë kryer pagesat e tyre për pjesëmarrjen në tender në datat 03.11.2022 deri 24.11.2022.

-Në datën 15.01.2017, donatori ka dhënë dakortësinë e tij me fax për rekomandimet e FSHZH lidhur me 4 ofertat e marra.

-Ofertat e ardhura janë “J.” & “C.” 3,076,415,70082 lekë me TVSH, “A.” 2,002,87,718.47 lekë me TVSH, “R.” 3,453,468,848.55 lekë me TVSH dhe “S.” 2,017,964,443.74 lekë me TVSH.

-Njoftimi për shpalljen e fituesit në faqen zyrtare të FSHZH, është me datë 02.02.2017 dhe cilëson se është shpallur fitues oferta me vlerën më të ulët ajo e operatorit ekonomik “A.” me ofertën me vlerë 2,002,87,718.47 lekë me TVSH.

Kontrata e punimeve:

-Në përfundim të procedurës së prokurimit dhe shpalljes së fituesit është lidhur kontrata me datë 24.02.2017 mes BOE “A.” dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me objekt ‘Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm’ me vlerë të kontratës 2,002,817,718.47 lekë me TVSh ose 1,669,014,765.39 lekë pa TVSH dhe me nr. CWC/ICB/2016/1, me afat të zbatimit të punimeve 36 muaj nga data e fillimit të punimeve si dhe me afat të garancisë së punimeve 365 ditë.

Kontrata e supervizonit

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE “P.” kompani kuvajtiane dhe “E.” kompani shqiptare me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit në datë 18.01.2018 mes këtij BOE dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) me vlerë të kontratës 1,986,300 euro pa TVSh ose 2,383,560 euro me TVSH, me afat të zbatimit të kontratës 48 muaj nga data e fillimit të shërbimit të konsulencës.

2.4.2 “Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se:

Me shkresën e datës 29.09.2017 nga ana e Drejtorit të Departamentit të Infrastrukturës z. T. B. i është bërë kërkesë Njesisë së Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit me objekt “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 2 Segmenti Ura e Gjormit – Brataj Ura a Laskos” me vlerë të projektuar 6,798,622,767 lekë pa TVSH.

Me Urdhër nr. 1 datë 03.10.2017 të ish – Titullarit të AK z. B. B. është prokuruar objekti me fondin si më sipër sipas llojit të procedurës *Tender i Hapur Ndërkombëtar (ICB)*, sipas *Udhëzuesit për Prokurimin, Kontraktimin dhe Zbatimin e Punimeve*. Në përbërje të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave janë caktuar punonjësit si më poshtë:

- z. L. M., Kryetar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike;
- z. E. Q., Anëtar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projektit të Turizmit;
- z. E. Gj.³, Anëtar, me pozicion Koordinator i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore;
- z. D. M., Anëtar, me pozicion Specialist i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore;
- z. E. O., Anëtar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projektit të Punëve në Komunitet;

Njoftimi për këtë procedurë është shpallur edhe në faqen Web të FSHZH, në një gazetë kombëtare si dhe në faqe Web ndërkombëtare. Me shpalljen e njoftimit, është bërë kërkesë për dokumentacion nga ana e 46 operatorëve ekonomikë dhe është aplikuar në total nga 18 operatorë ekonomikë. Në vijim rezulton se nga 18 OE është pranuar (kualifikuar pa kushte) për fazën e parë vetëm OE S., është pranuar me kusht OE N.I. dhe janë refuzuar aplikimet për 16 të tjerë.

Sipas raportit të vlerësimit të datës 09.12.2018 rezulton se kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 4 OE me të dhëna si më poshtë:

Tabela nr. 7

Nr.	OE	Vendi i Origjinës	Vlera e Ofertës (pa TVSH)
1	S.	V.	3,656,130,556
2	R.	R.	3,757,125,345
3	K.	A.	4,686,195,779
4	A.	B.	5,963,308,703

Ky raport vlerësimi ka marrë miratimin (No objection) nga ana e donatorit Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab sipas shkresës së datës 31.01.2019.

³Zëvendësuar me z. A. B. sipas Urdhrit nr. 1/1 datë 05.12.2018 të ish – Titullarit z. B. B.

Në vijim sipas Raportit të Vlerësimit të datës 04.02.2019 është vlerësuar nga ana e KVO, propozimi alternativ i OE S. me vlerë të këtij propozimi në shumën 3,616,665,343 lekë pa TVSH, ose 39,465,213 lekë pa TVSH më pak se vlera e ofertuar sipas projekt – preventivit të shpallur nga AK. Në lidhje me këtë propozim teknik të sjellë nga OE S., është marrë edhe miratimi përmes opionencës teknike administruar me nr. 13/2 prot., datë 31.01.2019. Me shkresën e datës 17.02.2019 është marrë miratimi për sa më sipër edhe i donatorit. Me Urdhrin e Brendshëm nr. 1, datë 04.03.2019 të ish – Titullarit të AK z. B. B. është emëruar komisioni i negocimit të kontratës me përbërje të këtij komisioni z. E. O., z. E. K., z. A. B. dhe z. A. Z.

Në përfundim të negociatave, sipas shkresës së datës 29.03.2019 është njoftuar OE S. për pranimin e ofertës dhe çmimin e kontratës në shumën 4,236,665,117 lekë me TVSH dhe me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullari të AK z. D. A. dhe përfaqësuesve të S. z. M. M. dhe z. I. T.

2.4.3 “Loti III - Segmenti Ura a Laskos – Qeparo Ura a Laskos – Kuç”

Me shkresën e datës 23.01.2018 nga ana e Drejtorit të Departamentit të Infrastrukturës z. T. B. i është bërë kërkesë Njesisë së Prokurimit për nisjen e procedurave të prokurimit me objekt “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 3 Segmenti Ura a Laskos – Qeparo Ura a Laskos – Kuç” me vlerë të projektuar 5,885,127,201.4 lekë pa TVSH. Me Urdhër nr. 3 datë 06.10.2017 të ish – Titullarit të AK z. B. B. është prokuruar objekti me fondin si më sipër sipas llojit të procedurës Tender i Hapur Ndërkombëtar (ICB), sipas Udhëzuesit për Prokurimin, Kontraktimin dhe Zbatimin e Punimeve. Në përbërje të Komsionit të Vlerësimit të Ofertave janë caktuar punonjësit si më poshtë:

- z. L.M., Kryetar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike;
- z. E.Q., Anëtar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projektit të Turizimit;
- z. E. Gj.⁴, Anëtar, me pozicion Koordinator i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore;
- z. D. M, Anëtar, me pozicion Specialist i Njesisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore;
- z. E. O., Anëtar, me pozicion Përgjegjës i Njesisë së Projektit të Punëve në Komunitet;

Njoftimi për këtë procedurë është shpallur edhe në faqen Web të FSHZH, në një gazetë kombëtare si dhe në faqe Web ndërkombëtare. Me shpalljen e njoftimit, është bërë kërkesë për dokumentacion nga ana e 48 operatorëve ekonomikë dhe është aplikuar në total nga 13 operatorë ekonomikë. Në vijim rezulton se nga 13 OE, janë pranuar (kualifikuar pa kushte) për fazën e parë 3 OE, janë pranuar me kusht 2 OE dhe janë refuzuar aplikimet për 8 të tjerë. Sipas raportit të vlerësimit të datës 18.12.2018 rezulton se kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 4 OE me të dhëna si më poshtë:

Tabela nr. 8

Nr.	OE	Vendi i Origjinës	Vlera e Ofertës (pa TVSH)
1	I.	I.	3,120,065,950
2	R.	A.	3,370,485,223
3	K.	T.	4,063,905,743
4	A.	A.	4,980,916,046

Ky raport vlerësimi ka marrë miratimin (No objection) nga ana e donatorit Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab sipas shkresës së datës 29.11.2018. Në vijim sipas Raportit të Vlerësimit të datës 25.01.2019 është vlerësuar nga ana e KVO, propozimi alternativ i OE INC S.P.A me vlerë të këtij propozimi në shumën 2,950,030,122.99 lekë pa TVSH, ose 170,035,827.01 lekë pa TVSH më pak se vlera e ofertuar sipas projekt – preventivit të shpallur nga AK. Në përfundim të negociatave, sipas shkresës së datës 30.01.2020 është

⁴ Zëvendësuar me z. A.B. sipas Urdhrit nr. 1/1 datë 05.12.2018 të ish – Titullarit z. B. B.

njoftuar OE I. për pranimin e ofertës dhe çmimin e kontratës në shumën 3,540,036,147.59 lekë me TVSH dhe me datë 08.05.2020 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D. A. dhe z. G.K dhe përfaqësuesve të I. z. R.R. dhe z. B.M.

2.5 Mbi zbatimin e kontratave në drejtim të realizimit të punimeve.

Në lidhje me Projektin “*Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës*”, fondet e të cilave janë siguruar nga Fondi Kuvajtian dhe Fondi Saudit si dhe Qeveria Shqiptare, sipas marrëveshjeve përkatëse, rezultojnë se punimet e ndërtimit janë parashikuar të ndahen në tre Lote, konkretisht:

- Loti 1 - Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm;
- Loti 2 - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos;
- Loti 3 - Ura e Laskos – Qeparo dhe Ura e Laskos – Rruga e lidhjes me Kuçin;

Nga këto, janë lidhur kontratat për akset Lot 1, Lot 2 dhe Lot 3.

Mbështetur në Programin e Auditimit, u auditua zbatimi i punimeve për kontratat me objekt “*Loti I - Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm*” dhe “*Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos*” pasi kontrata tjetër për Lotin III ka nisur punimet në 08.05.2020.

2.5.1 Kontrata “*Loti I - Ndërtimi i rrugës së Bypassit të Vlorës – Peshkëpi – Gjorm*”

Tabela nr. 9

Të dhëna të përgjithshme Emri i Projektit	Rindërtimi i rrugës Vlorë bypass – Peshkëpi – Ura Gjorm Lot 1
Numri i identifikimit të kontratës	CWC/ICB/2016/1
Financuesi i projektit	Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (KFAED) & Qeveria Shqiptare
Numëri i Huas	943
Klient / Punëdhënësi	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)
Konsulent	J. E.
Kontraktori	A.
Nën-Kontraktor	A. D. N.
Periudha e vendosur e kohës së zbatimit	30 Mars 2017- 29 Qershor 2019 (27 muaj)
Vlera e kontratës pa TVSH	1,669,011,265 lekë
Vendndodhja	Qarku i Vlorës-Lugina e Lumit të Vlorës (Shushica)
Gjatësia e Projektit	23.166 Km
Certifikata e marrjes në dorëzim	26.11.2019
Certifikata finale e pranimit pas periudhës së garancisë.	26.11.2020

1. Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: 1- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore nga IPC nr. 1 deri tek IPC nr. 10; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Praktikat e Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3; Etj. 2- Korrespondencat mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar (IPC nr. 10) volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në dy zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Tabela nr. 10

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	E/1.2	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 1.0 m ³ , në kanale me gjerësi > 2 m, tokë e zakonshme, kat. IV me shkarkim në mjet	695,700
2	E/1.8	F.V Tub PVC Ø - 90 mm	611,414
SHUMA			1,307,114

Konkretisht, argumentimet e këtyre diferencave pasqyrohen në tabelën përkatëse të përshkruar në Aneksin 2.5.1.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me zërin Tek kategoria E, Zëri D/10 Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit, sipas librezës së masave dhe situacionit përfundimtar janë pasqyruar volumi total prej 18,847.37 m². Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konkretisht materialeve fotografike të dosjes teknike si dhe verifikimit në terren në prezencë të konsulentit dhe përfaqësuesve të FSHZH, konstatohet se ky volum në disa raste është kryer me material zhavorri të përzier me tokë vegjetale. Pavarësisht sa më sipër rezulton se kanalet rezultojnë të qëndrueshme dhe pa devijime apo mangësi të drejtim të shfrytëzimit të rrugës. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se tek kategoria G Punime Bioinxhinierike, Zëri G/2 Rrafshim skarpate në gërmim, konstatohet se sipas librezës së masave (dokumenti Measurement Sheets), janë pasqyruar volumi për rrafshimin e skarpateve prej 90,751.71 m². Në fakt, referuar verifikimit në terren të punimeve faktike në prezencë të supervizorit si dhe kronologjisë së punimeve arrihet në konkluzionin se volumet e punës për këtë zë janë kryer gjatë punimeve të gërmimit nën zërat ‘Gërmim në tokë kategoria III seksion i detyruar për formimin e trupit të rrugës me ekskavator me zinxhir 1m³ përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gërmim në tokë kategoria IV seksion i detyruar me ekskavator 1m³ me zinxhir për formimin e trupit të rrugës përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gërmim në tokë kategoria III për heqjen e tokës vegjetale seksion të lirë me ekskavator me zinxhirë 1m³’, ‘Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet’ si dhe zërin ‘Gërmim në tokë kategoria III për gjerësi kanali deri në 2 m me ekskavator me zinxhir 0.5m³ me shkarkim në mjet’. Gjithashtu, konstatohet se nën këtë zë janë likuiduar edhe volume pune për rrafshimin e materialeve shkëmbore, rrafshimin e kanaleve si dhe rrafshimin e sheshpushimeve të shkallëzimeve. Referuar Specifikimeve teknike, pika 4.05 rezulton se është cituar se: *Gërmimet e Përgjithshme përbëhen nga gërmimet për hapjen e rrugës, vendeve të ndërrimit dhe pune ndihmese si për shembull, gërmimet për segmente të rrugës në prerje, nivelimi i dherave, rregullimi i skarpateve në gërmim apo mbushje, formimi dhe thellimi i bazamentit të mbushjes, kanalet anësore, kanalizimet e nëndheshme, kanalet etj., si edhe ato për themele të strukturave*. Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste skarifikimi i skarpateve nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave

	dhe projektit (nuk është kryer në plan të rrafshët) por është kryer me diferenca. Për rrjedhojë rezulton se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet fondet në shumë 11,467,645 lekë pa TVSH.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i>; - Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> Pika 8.1: <i>“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”</i>; - Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“3.2 Libreza e masave (Measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”</i>; Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit: • Artikulli 3 <i>Obligimet e Kontraktorit</i> tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2; • Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm <u>Qëllimi i Shërbimeve</u>; • Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit; - Kushtet e Kontratës FIDIC, klauzola 38.1 e Kushteve të Përgjithshme ku përcaktohet se: <i>Asnjë pjesë e punimeve nuk duhet të mbulohet apo të hiqet nga pjesa e dukshme pa miratimin e Inxhinierit dhe Kontraktori duhet të përballojë plotësisht mundësitë që Inxhinieri të ekzaminojë dhe të masë këto pjesë të punimeve të cilat janë duke u mbuluar apo të vendosen jashtë shikimit dhe të ekzaminojë themelet përpara vendosjes së ndonjë pjese tjetër aty. Kontraktori duhet të njoftojë Inxhinierin kurdo kur punime të tilla apo</i>

	<i>themele janë gati apo janë duke u bërë gati për tu ekzaminuar nga Inxhinieri dhe Inxhinieri, pa ndonjë vonesë të paarsyeshme, përveçse kur ai e konsideron të panevojshme dhe duke ja këshilluar këtë Kontraktorit, merr pjesë në ekzaminimin dhe matjen e këtyre pjesë të punimeve apo këtyre themeleve.</i>
1.1 Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 1,307,114 lekë pa TVSH.
1.2 Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet i fondeve të projektit në shumën 11,467,645 lekë pa TVSH.
Shkaku	Likuidimi i volumeve të punimeve të pakryera në fakt nga ana e sipërmarrësit si dhe prej mbivendosjes së zërave të preventivit.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës 1,307,114 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit OE A.T. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 24.02.2017 me nr. CWC/ICB/2016/1 me objekt ‘Rindërtimi i rrugës Vlora bypass – Peshkepi – Ura Gjorm Lot 1’.
1.2 Rekomandimi:	FSHZH të marrë masa për shmangien e praktikave në të cilat konstatohen mbivendosje zërash të ndryshëm për të njëjtët procese pune me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet të fondeve të projekteve.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2. Titulli i gjetjes:	Emërimi i Mbikëqyrësit të Përkohshëm në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, rezulton se Kontraktori A. ka nisur punimet në datën 30.03.2017 me njoftimin për fillimin e punimeve nga mbikëqyrësi i përkohshëm i emëruar nga klienti (FSHZH). Me Vendimin nr. 04, datë 27.03.2017 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH (Klienti), është emëruar z. Xh.N. si mbikëqyrës i përkohshëm i punimeve për objektin “ <i>Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës aksi Selenicë-Kuç-Qeparo</i> ” Lot 1. Në fakt veprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë rezultuar në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, për zgjedhjen e konsulentit. Gjithashtu, nuk është respektuar Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, neni 122 pika 2 ku përcaktohet përparësia e marrëveshjeve ndërkombëtare, në rastin kur ligjet e vendit nuk pajtohen me të. Në shkresën e kontraktorit Ref. Nr. ATM/BA/pmt/006 datë 09.06.2017, drejtuar klientit (FSHZH), është bërë me dije mungesa e funksionimit të mbikëqyrësit të përkohshëm. Me shkresën e sipërcituar është njoftuar klienti (FSHZH), se nuk është marrë akoma njoftimi zyrtar për fillimin e punimeve, gjithashtu nuk është rishikuar nga mbikëqyrësi i përkohshëm programi në vendin e punimeve dhe përcaktimi i buxhetit me ndryshimet e mundshme përkatëse.

Kërkesa e sipërcituar nga Kontraktori është mbështetur në Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, ku përcaktohet se inxhinieri (konsulenti) i caktuar nga punëdhënësi vepron si inxhinier për qëllimet e kontratës dhe jo si inxhinier thjesht i emëruar. Gjithashtu, sipas pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b) inxhinieri siguron aprovimin specifik përpara se klienti (FSHZH) të ushtrojë autoritetin e tij. Mbikëqyrësi i përkohshëm, gjatë periudhës 30.03.2017-31.01.2018, nuk ka mundur të ushtrojë veprimtarinë e tij për kontrollin dhe certifikimin e punimeve të kryera. Mbikëqyrësi, duke qenë një individ i emëruar, nuk plotësonte kushtet lidhur me kapacitetet e konsulentit të parashikuara në termat e referencës, ku është parashikuar një staf me disa inxhinierë mbikëqyrës në vend, inxhinierë të kontrollit të cilësisë, inxhinierë topograf, si edhe specialist ambienti, etj. Qëllimi i shërbimit të mbikëqyrjes (konsulentit apo inxhinierit), konform pikës 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi), është të sigurojë implementimin e projektit në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike, si dhe të sigurojë që shërbimet teknike të jenë të lidhura me interpretimet e dokumenteve të kontratës, kontrollin e shpenzimeve, certifikimin e materialeve, volumet dhe faturat e dorëzuara nga Kontraktori, gjithashtu, ndryshime të tilla të projektit dhe specifikimeve teknike që bëhen të domosdoshme gjatë realizimit të projektit. Nga ana e klientit (FSHZH) nuk është provuar me dokumente, raportime dhe akte që mbikëqyrësi i përkohshëm të ketë ushtruar kontrollet e sipërpërmendura, orientimet (instruksionet), dhe certifikimet e punimeve përkatëse. Nga auditimi konstatohet se Kontraktori ka kryer punime në vlerën prej **686,634,246 lekë** pa TVSH për periudhën 30.03.2017-30.01.2018, dhe për shkak të mungesës të funksionimit të mbikëqyrjes (certifikimin e punimeve dhe miratimit të situacioneve përkatëse) nuk ka marrë asnjë pagesë. Kontrata e shërbimit të konsulencës për projektin *“Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”*, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit J. E. është lidhur në datë 18.01.2018, ndërkohë që punimet kishin filluar në datë 30.03.2017. Nga shërbimi i konsulencës është miratuar Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës (IPC) nr. 1 datë 21.05.2018 për periudhën e punimeve 30.03.2017-31.03.2018 dhe për volumet që janë mbështetur me dokumente justifikues, në vlerën prej **395,110,145.00 lekë** ose 23.7 % e vlerës gjithsej prej 1,669,014,765 lekë pa TVSH, të parashikuar në preventivin fitues të tenderit. Sa sipër, Kontraktori ka patur një progres të ulët të kryerjes së punimeve. Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës nr. 1 (IPC nr. 1) është dorëzuar nga Kontraktori për shqyrtim tek konsulenti në datë 24.04.2018. Certifikata e Marrjes në Dorëzim (TOC) është lëshuar nga konsulenti në datën 26/11/2019. Certifikata Finale e Pranimit, pas periudhës së përgjegjësisë për defektet, është lëshuar në datën 26.11.2020. Veprimet e Fondit Shqiptar të zhvillimit rezultojnë në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017 dhe pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b), gjithashtu në kundërshtim me pikën 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi) si dhe me kushtet teknike të parashikuara në projektin e zbatimit, duke shkaktuar si pasojë kryerjen e punimeve nga Kontraktori pa miratimin paraprak dhe pa certifikimin e konsulentit, në vlerën prej

	686,634,246 lekë pa TVSH. Këtë e vërteton jo vetëm fakti se për periudhën në fjalë Kontraktori nuk ka përfituar asnjë pagesë nga klienti, por edhe fakti që punimet e kryera për periudhën e mësipërme janë certifikuar për herë të parë nga konsulenti i përzgjedhur J. E., i cili ka filluar veprimtarinë në fillim të Shkurtit 2018. Veprimet e Klientit në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator kanë shkaktuar rritjen e riskut për kryerjen e punimeve jashtë standardeve të parashikuara në specifikimet teknike. Faktikisht sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga inspektimi në vendin e punimeve të konsulentit, në datat 19-20 Qershor 2018, është gjetur se Kontraktori nuk ka përmbushur specifikimet teknike për shtresën e zhavorrit të imët (ana e djathtë e rrugës) në seksionet si më poshtë: -km 1+600-km 1+670 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur 5-10 cm - km 1+950-km 2+125 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur më pak se 10 cm. Sipas seksionit 28.02, pika 4 e Specifikimeve Teknike, gjerësia e seksionit tërthor të shtresës duhet të ishte 20 cm. Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara (përfshi 3 muaj shtesa e miratuar). Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara (përfshi 3 muaj shtesa e miratuar).
Kriteri:	Marrëveshja e Huas, neni IV seksioni 4.04 <u>ku përcaktohet se:</u> Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH të realizojë Projektin me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktikën e duhur inxhinierike, administrative dhe financiare. seksioni 4.05 <u>ku përcaktohet se:</u> Në kryerjen e Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH të punësojë konsulentë inxhinierikë të pranueshëm për dhe sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin. Shtojca 3, pika 4, e Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, <u>ku përcaktohet se:</u> “Në lidhje me shërbimet e konsulentëve të kërkuara për punimet, këto shërbime do të prokurohen në përputhje me Udhëzimet e Fondit për Përdorimin e Konsulentëve, si dhe procedurat e deklaruara në këtë shtojcë. Një listë e përzgjedhur e të paktën 6 konsulentëve kuvajtanë dhe një numër i ngjashëm i konsulentëve lokale do të përgatitet në marrëveshje me Fondin dhe konsulentët në listën e përzgjedhur do të ftohen për të paraqitur propozimet e tyre. Vlerësimi në çdo fazë do të kryhet në përputhje me kriteret e miratuara me Fondin paraprakisht dhe të përcaktuara në ftesën e propozimeve”. Neni 122 pika 2, Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit, që nuk pajtohen me të”. Pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) II A e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, <u>ku përcaktohet se:</u> “Inxhinieri (konsulenti) i caktuar nga punëdhënësi vepron si inxhinier për qëllimet e kontratës dhe jo si inxhinier thjesht i emëruar”. Pika 5, nën-pika 2.1(b) Kushtet e kontratës së punimeve II A; Pika 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi), <u>ku përcaktohet se:</u> “Inxhinieri siguron aprovimin specifik përpara se klienti të ushtrojë autoritetin e tij. Qëllimi i shërbimit të mbikëqyrjes (konsulentit apo

	<i>inxhinierit), është të sigurojë implementimin e projektit në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike, si dhe të sigurojë që shërbimet teknike të jenë të lidhura me interpretimet e dokumenteve të kontratës, kontrollin e shpenzimeve, certifikimin e materialeve, volumet dhe faturat e dorëzuara nga Kontraktori, gjithashtu, ndryshime të tilla të projektit dhe specifikimeve teknike që bëhen të domosdoshme gjatë realizimit të projektit”.</i>
Ndikimi:	Punime të kryera të pa certifikuara, duke shkaktuar zgjatje të afatit të përfundimit të kontratës nga 39 në 44 muaj.
Shkaku	Mungesa e funksionimit të mbikëqyrësit për rreth 10 muaj.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Drejtori Ekzekutiv i FSHZH me Departamentin e Menaxhimit të Projekteve dhe Njësinë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të analizojnë rezultatet e dy loteve të para të projektit “ <i>Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës</i> ”, si edhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për një koordinim më të mirë midis aktorëve përgjegjës për realizimin e projektit brenda afateve të parashikuara nga Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Pretendimi i subjektit:

“Ashtu si edhe ju kemi sqaruar në observacionin e dërguar në vijim të Akt Konstatimit përkatës ju shpjegojmë se gjetja juaj është bërë në interpretim të gabuar të ligjit. Ju i referoheni marrëveshjes së huas datë 30.03.2016 ‘Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës’...”

Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga Grupi i Auditimit pasi ato nuk sjellin fakte shtesë nga ato të konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren.

2.5.2 Kontrata “Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos”

Me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D. A. dhe përfaqësuesve të S. z. M. M. dhe z. I.T. me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Pas mbajtjes së Dokumentit Minutat e takimit të datës 09.05.2019, janë caktuar në këtë takim data e fillimit të punimeve 13.05.2019 dhe data e aksesit në kantier data 16.05.2019. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit të AK z. D. A., kërkesa e kontraktorit S. për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E. në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE R. në masën 45 %.

Me datë 13.05.2019 është mbajtur procesverbali i fillimit të punimeve, procesverbali i marrjes në dorëzim të sheshit të ndërtimit si dhe akti i piketimit të objektit.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe situacionin përfundimtar.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore IPC; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Etj. si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se

janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në shumën prej **129,292,638.45 lekë pa TVSH** në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Tabela nr. 11

Nr.	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
Segmenti 1 Ura e Gjormit - Brataj		
1	Gjeotekstil me gramaturë 200 g/m ²	317,795
2	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	1,733,535.79
3	Gërmim në shkëmb seksion i detyruar me ekskavator 0.5 m ³ me zinxhir me gjerësi kanali 2 m me shkarkim në mjet	427,063
4	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	5,904,329
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	1,853,189
6	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	3,921,855.09
7	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	1,667,022.8
8	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	930,581.6
9	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	2,118,142
10	Rrafshim skarpate në gërmim	1,371,810
11	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	462,742.89
12	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	940,401.79
13	Punimet e gërmimit në seksionin në piketën 5+831	3,665,808
14	Transporti i materialit të gërmuar	23,692,449.49
SHUMA Segmenti 1		45,340,917.45
Segmenti 2 Brataj – Ura e Laskos		
1	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	3,230,033.63
2	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	8,216,401
3	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	1,451,613
4	F V hekur betoni i zakonshëm për kanalin e betonit Ø 6 ~ 10mm	2,045,659
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	5,412,793.44
7	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	6,155,009.91
8	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	2,098,985
9	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	1,374,436.44
10	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	10,574,022.5
11	Rrafshim skarpate në gërmim	3,086,247.46
12	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	834,002.45
13	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	1,670,423.39
14	Mbushje, përhapje dhe ngjeshje me zhavorr në trupin e rrugës	1,098,010
15	Transporti i materialit të gërmuar	36,704,083.86

SHUMA Segmenti 2	83,951,721
TOTAL	129,292,638.45

Gjithashtu, rezultoi se gjendja e skarpateve në një pjesë të tyre ishte problematike pasi në shumë raste realizimi i tyre nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit, pra nuk është kryer në plan të rrafshët por është kryer me diferenca të dukshme duke lënë në shumë raste edhe gjurmët e gërmimit me ekskavator apo me mjete të tjera. Në rastet kur janë hasur materiale shkëmbore, gërmimi nuk është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit. Për rrjedhojë nuk është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve duke bërë që në shumë raste kanalet të jenë me material të rrëzuar nga këto skarpate. Përveç sa më sipër u shpjegua në lidhje me skarpatat e rrugës, rezulton se nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të kontratës pasi në pjesën më të madhe të tyre, skarpatat rezultuan të shembura dhe/ose jo të qëndrueshme, me material të shkrifët në rrugë, kanalet rezultuan të mbushur me materialin e rrëzuar nga skarpatat dhe në shumë raste masivet e gurëve me dimensione të konsiderueshme ishin në rrugë duke u bërë kështu një shkak i mundshëm për ndodhjen e aksidenteve. Grupi i Auditimit kreu verifikim të të gjithë aksit për të dy segmentet dhe situata e skarpateve dhe pjesërisht ajo e kanaleve rezultoi të ishte tejet problematike. Konkretisht, referuar specifikimeve teknike Seksioni 4, pika 4.01, janë cituar ndër të tjera se: “ ... Gërmimet dhe mbushjet e nevojshme për krijimin e trupit të rrugës, kanalet kulluese anesore, akseset, kalimet dhe pjerrësitë dhe të tjera si këto, si edhe për ndërtimin e strukturave, duhet të bëhen në format dhe dimensionet e treguara në vizatimet përkatëse ... Duhet treguar kujdes i veçantë në dhënien formës ekzakte kanaleve kulluese, në nivelimin dhe krijimin e bankinave, në profilizimin e skarpateve dhe të anëve të rrugës ... Pjerrësitë e gërmimeve dhe mbushje duhet të kryhen sipas pjerrësisë së përshtatshme sipas natyrës dhe karakteristikave fiziko-mekanike të formacioneve dhe gjithsesi, sipas instruksioneve me shkrim të Supervizorit ... Kontraktori duhet, me shpenzimet e veta, do të bëjë të gjitha testet e nevojshme që duhet të kryhen në laboratorin e kantierit dhe të përcaktojë natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë, për të përcaktuar mundësinë e përdorimit dhe metodave që do të ndiqen në përdorim”.

Në fakt nga verifikimi në terren u konstatua se në shumë raste këto pjerrësi nuk përputheshin me projektin e zbatimit. Konkretisht, kjo mos përputhje qëndronte në ndryshimin e këndeve të pjerrësisë mes vizatimit dhe faktit, apo masive të pa gërmuara në skarpatë të cilat nuk krijojnë një plan të rrafshët ashtu siç edhe është paraqitur detaji i projektit mbi të cilin janë kryer edhe volumet e punës për pagesat e kryera ndaj kontraktorit të punimeve S. Për rrjedhojë rezulton se nuk është treguar kujdes i veçantë në dhënien e formës ekzakte të pjerrësive dhe përveç kësaj, këto pjerrësi nuk janë kryer në përshtatje me karakteristika fiziko – mekanike të formacioneve. Në dosje nuk disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë. Për sa i takon kanalet të betonit në shumë raste u konstatua mos respektim i detajeve të projektit, kryesisht për sa i përket formës lineare, estetike në dimensione në disa raste dhe pa respektuar as trashësinë dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të

	projektit. Konkretisht, nga inspektimi rezultoi se për punimet e betonit të kanaleve anësore nuk është respektuar trashësia e kanalit e parashikuar për tu kryer në masën 10 cm si dhe nuk është realizuar as përforcimi me hekur i segmentit nga PK 5+197.61 deri në PK 5+799.54. Si pasojë e mos respektimit të detajeve të projektit rezultoi se janë dëmtuar kanalet e kullimit duke u çarë dhe duke mos kryer kështu funksionin kryesor të tyre.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”</i> Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 <i>“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> Pika 8.1: <i>“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”</i> Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 <i>“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“3.2 Libreza e masave (measurement sheet) për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. 3.3 Situacionet (IPC) mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.</i>
1.1 Ndikimi:	Punime të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe situacionin përfundimtar në shumën prej 129,292,638.45 lekë pa TVSH.
Shkaku	Mungesa e kontrolleve nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e vlerës 129,292,638.45 lekë pa TVSH në lidhje punët e kryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe/apo të kryera jo sipas përshkrimeve të bëra në situacionin përfundimtar, kjo përmes edhe një verifikimi më të plotë në terren ⁵ si dhe nxjerrjen e një konkluzioni për kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 17.04.2019 me

⁵ Ky rekomandim është vendosur nisur nga pretendimet e subjektit të audituar se gjatë verifikimit në terren GA realizoi sondazhe jo për çdo km por në disa pika të rastësishme.

	objekt <i>'Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 2 Segmenti Ura e Gjormit – Brataj Ura a Laskos'.</i>
1.2 Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të skarpateve gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit, për kryerjen e një azhurnimi topografik, me qëllim saktësimin e volumeve të punimeve të kryera dhe korrigjimin (në rast të konstatimit të ndryshimeve) të volumeve të situacionit përfundimtar të zërave që preken nga këto ndryshime.
1.3 Rekomandimi:	Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të kanaleve anësore të betonit gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit ku u konstatua mungesa e respektimit të dimensioneve dhe materialit përforcues (hekur), për kryerjen e sondazheve shtesë me qëllim identifikimin e të gjitha rasteve të tjera ku nuk janë respektuar detajet e projektit të miratuar. Pas kryerjes së këtyre sondazheve, në rast të konstatimit të ndryshimeve nga ato të deklaruara në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të reflektohen ndryshimet në volume dhe në vlerë.

Lidhur me sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Konsulentit BOE P. E. z. M.G.

Nga ana e subjektit të audituar është dërguar observacioni i administruar në FSHZH me nr. 241/18 , prot., datë 15.07.2022 dhe në KLSH me nr. 6/8 prot., datë 18.07.2022.

Në përfundim të trajtimit të observacioneve si dhe argumenteve të dhëna gjatë takimit ballafaques, përmbyllës në KLSH, Grupi i Auditimit ka marrë pjesërisht në konsideratë observacionin duke bërë edhe riformulimin e rekomandimeve si më sipër.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me marrëveshjet e financimit rezulton se marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 50/2016, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”* ka parashikuar përfundimin e Projektit me datë 31.12.2019, përfundimin e afatit të disbursimit me datë 31.12.2020 si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	<u>Ndërtimi i punimeve civile</u>	9,913,000	77 %
2	<u>Shërbime Konsulence</u>	777,000	100 %
3	<u>Kontigjenca të pa alokuara</u>	1,310,000	
	TOTAL	12,000,000	

Në lidhje me sa më sipër duhet theksuar fakti se termi *‘Projekt’* i referohet pjesës koresponduese të punimeve dhe konsulencës që mund të realizohet me këtë shumë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/1 prot., datë 25.02.2019 është bërë kërkesë për rialokimin e fondeve nga kategoria

Kontigjenca të pa alokuara në shumën 1,310,000 KD në llogari të kategorisë *Ndërtimi i punimeve civile*, shtyrjes së datës së përfundimit të punimeve deri me datë 31.12.2021 si dhe zgjatjen e afatit të disbursimit të fondeve të Projektit deri me datë 31.12.2022. Konkretisht është kërkuar të miratohet kalimi i fondeve sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	<u>Ndërtimi i punimeve civile</u>	11,223,000	77 %
2	<u>Shërbime Konsulence</u>	777,000	100 %
3	<u>Kontigjenca të pa alokuara</u>	0	0
	TOTAL	12,000,000	

Me shkresën nr. 4344/1 prot., datë 27.03.2019, administruar në FSHZH me shkresën me nr. 438/1 prot., datë 29.03.2019, është dërguar nga ana e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj, Sektori i Sigurimit të Ndihmës së Huaj dhe Marrëveshjeve, shkresa me lëndë *Mbi kredinë e Fondit të Kuvajtit për financimin e Projektit të rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës*. Sipas kësaj shkrese MFE ka njoftuar FSHZH për miratimin e rialokimit të fondeve dhe për faktin se Fondi Kuvajtian nuk ka shprehur ndonjë kundërshti në lidhje me shtyrjen e afateve si dhe për faktin se kanë qenë duke u vijuar komunikimet me Fondin Kuvajtian me qëllim formalizimin e ndryshimeve të kërkuara nëpërmjet një dokumenti ndryshues. Në fakt, referuar këtij dokumenti të datës 26.03.2019 bashkëlidhur rezulton se nga ana e Fondit Kuvajtian është dhënë miratimi për rialokimin e fondeve si dhe për zgjatjen e afatit të disbursimit por nuk është shprehur mendim në lidhje me zgjatjen e afatit të realizimit të Projektit. Pas një kërkesë të Fondit Kuvajtian në lidhje me një dokument amendimi të propozuar nga pala shqiptare, me shkresën e administruar në MFE me nr. 2455/4 prot., datë 03.07.2019 është dërguar në FSHZH për mendim draft dokumenti ndryshues i Marrëveshjes së Huas duke përfshirë në këtë draft ndryshimet në lidhje me:

- Rialokimin e fondeve të kontigjencës;
- Shtyrjen e afatit të përfundimit të Projektit deri më datë 31.12.2021;
- Shtyrjen e afatit të disbursimit deri më 31.12.2022;

Në rrugë elektronike i është dërguar Fondit Kuvajtian më datë 16.07.2019 Drafti i ndryshimit të Marrëveshjes së Huas si më sipër nga ana e të cilit është kthyer përgjigje me datë 05.09.2019 duke miratuar këtë Draft. Me shkresën e administruar në MFE me nr. 19184/5prot., datë 28.01.2020 është njoftuar Fondi Kuvajtian në lidhje me Miratimin në Parim të Marrëveshjes Ndryshuese të Marrëveshjes së Huas dhe me pas kjo është miratuar me VKM nr. 178, datë 26.02.2020 “Për miratimin e Marrëveshjes Ndryshuese, me Shkëmbim Letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit, për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 50/2016”. Nga sa më sipër rezulton se miratimi me VKM i shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve është kryer përtej afatit në të cilin punimet duhet të kishin përfunduar, kjo pavarësisht miratimit me shkëmbim letrash mes palëve. Sa më sipër është në kundërshtim me marrëveshjen e ratifikuar me ligjin nr. 50/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”, Shtojca 2 Përshkrimi i Projektit si dhe Ligji nr. 43/2016, “Për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 Ndryshimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 16 – 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH, në cilësinë e Njësinë Zbatuese të Projektit, të merren masa për të intensifikuar përpjekjet për miratimin në kohë dhe brenda afateve të parashikuara

të ndryshimeve të kushteve të marrëveshjeve të financimit si dhe njoftimin e MFE për rastet kur marrëveshjet janë në kushtet e zbatimit të tyre jashtë afateve të miratuar në marrëveshjet përkatëse.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me objektivat e projektit rezulton se në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab, datë 30.03.2016, është përcaktuar se komponentët kryesorë të projektit do të jenë si më poshtë:

1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës; 2. Shtrimi i sipërfaqes; 3. Rehabilitimi i kullimit, duke përfshirë ura, tombino, mure mbajtës, gjithashtu siguria dhe ndriçimi, etj. 4. Shërbimi i konsulencës.

Gjithashtu, objektivi kryesor i projektit është përcaktuar realizimi i punimeve në përputhje me standardet e pranura dhe *qëndrueshmëria e infrastrukturës publike*, në zonën e Bregdetit të Jugut, specifikisht në zonën e Lumit të Vlorës, duke kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Në zbatim të kërkesave Shtojca 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, është lidhur Kontrata e Shërbimit të Konsulencës për projektin *“Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës”*, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit *“J. E.”* në datë 18.01.2018.

- Nga auditimi, nuk rezulton vlerësimi i objektivave se projekti do të gjenerojë një numër të konsiderueshëm të përfitimeve social-ekonomike dhe ambientale si *Mundësinë e hyrjes në rrugën e përmirësuar; Mundësi më e madhe për lidhjen me tregjet rajonale dhe lokale për tregtimin e produkteve lokale, përmirësimin e ndërveprimit social; Uljen e papunësisë nëpërmjet krijimit të punëve të reja dhe intensifikimit të aktiviteteve ekonomike ekzistuese; Diversifikimin e ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të aktiviteteve të turizmit; Bashkëveprimin social të përmirësuar dhe rritjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive; Pakësimin e familjeve që jetojnë nën nivelin e varfërisë, etj*, parashikuar në Shtojcën A, pika II Objektivat, të kontratës së sipërcituar (ToR).

- Nga auditimi, rezulton se Kontraktori nuk ka respektuar kriteret ku kërkohet që Raporti Fillestar duhet të përshkruaj planin që Konsulenca ka vendosur lidhur me detyrat e saj, si edhe stafin, gjithashtu edhe vërejtjet siç ajo i gjykon parashikuar në pikën 2, Shtojca B *“Kërkesa Raportuese”* të Kontratës Konsulencës.

- Nga auditimi, rezulton se FZSHH nuk ka administruar një Raport Fillestar (Inception Report) i konsulentit me elementet kryesorë përbërës, ku përfshin synimet dhe objektivat e projektit, gjithashtu Manualin e Kontrollit të Cilësisë bashkëlidhur, parashikuar në seksionin VI, Shtojca A, të Kontratës së Konsulentit.

- Gjithashtu rezulton se FZSHH nuk ka të dhëna për punësimin e punëtorëve lokalë nga Kontraktori sipas përcaktimeve në Kontratën e Punës, Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, paragrafi i shtuar i nën-pikës 34.1.

- Nga raportet e konsulentit nuk rezulton të jetë raportuar në mënyrë të veçantë për infrastrukturën urbane, gjithashtu mbi realizimin e hyrjeve-daljeve të fshatrave të zonës në rrugën e Lumit të Vlorës, për pasojë nuk rezulton e qartë mënyra dhe përgjegjësia e realizimit të tyre sipas kërkesave në seksionin II, Shtojca A, *“Përshkrimi i Projektit”* të Kontratës së Konsulentit ku përcaktohet se ndërtimi i infrastrukturës urbane përbëhet nga trotualet, zonat e parkimit, ndriçimi publik, vendosja e kabllit optik, instalimi i sinjalistikës rrugore, etj.

- Gjithashtu me përfundimin e punimeve, (dy lotet e para) bashkitë respektive për çdo prej kontratave të punimeve, gjatë inspektimeve të tyre nuk kanë marrë pjesë, dhe për pasojë nuk kanë firmosur Certifikatat e Përfundimit të Punimeve siç është parashikuar në nenin 5 *“Për realizimin e punimeve”* të Marrëveshjeve të Investimit.

Sa sipër, duke qenë se pronari i rrugës që rehabilitohet është Autoriteti Rrugor Shqiptar, kontratat e mësipërme nuk kanë krijuar mundësi për funksionimin e duhur midis aktorëve të projektit dhe për këtë arsye ato duhet të përmirësohen. Sa më sipër është në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Veçantë, Pjesa II A, pika 27, nën-pika 34.1, të kontratës së punimeve, Kapitulli IV Shtojca, Aneksi A, seksionet II dhe VI, e Kontratës për Shërbimin e Konsulencës “Për rehabilitimin e rrugës së Lumit të Vlorës”, ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe JV “P.” & “E.”, datë 18.01.2018, Kreu II Objektivat si dhe Kërkesat e Shtojcës 2, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 19 – 22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i FSHZH, nëpërmjet Departamentit të Menaxhimit të Projekteve, si edhe Njesisë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të marrë masa për vlerësimin aktual të objektivave të matshëm për projektin “Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës” deri në përfundimin e projektit me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë të infrastrukturës urbane dhe përfundimin me sukses të rehabilitimit të rrugës të Lumit të Vlorës.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i FSHZH të marrë masa për ndryshimet përkatëse të marrëveshjeve të investimeve me bashkitë, për të përcaktuar kërkesa dhe përgjegjësi të qarta vendimmarrjen nga ana NjVV për pjesë e tyre të territorit, ashtu edhe për pjesëmarrjen e tyre si aktorë në realizimin e projektit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me disbursimet referuar pjesës së financimit të Kredisë nr. 943, për Projektin për sa i përket kontratave të sipërmarrjeve të punimeve për Lot I dhe Lot II është konstatuar se në pesë raste disbursimet e IPC^{ve} nuk janë kryer brenda afateve të parashikuara në klauzolën nr. 60.11 të kontratave. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se janë hasur vonesa në disbursimin e IPC^{ve} për pjesën takuese prej 77 % të mbuluar Fondi Kuvajtian. Nga këto 5 raste, në 2 prej tyre, sipas shkresës së administruar në FSHZH me nr. 889 prot., datë 07.06.2019, nga ana e Kontraktorit për LOT 1 “A”, janë paraqitur ankesa (*Claim*) për IPC^{te} 5 dhe 6. Në vijim të korrespondencave mes Fondit Kuvajtian, FSHZH, Kontraktorit dhe Supervizorit është dakordësuar mes palëve tërheqja për ankesën me datë 03.07.2019 në takimin e muajit. Sa më sipër është në kundërshtim me Klauzolën 60.11, e Kontratave të Sipërmarrjes së Punimeve për Lot I dhe Lot II.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga FSHZH, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve dhe Përgjegjësi i Njesisë së Projektit të merren masat e nevojshme organizative dhe mbikëqyrëse duke shmangur të gjitha praktikatat penguese në disponibilitetin e fondeve në mënyrë që procesi i pagesave të IPC^{ve} të realizohet brenda afateve të përcaktuar në kontratë duke eliminuar mundësitë për penalitete (*Claim*) nga kontraktorët.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me disbursimet rezulton se në Marrëveshjen Financiare të ratifikuar me ligjin nr. 50/2016 datë 5.5.2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab t të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” me vlerë financimi 12,000,000 dinarë kuvajtian (afërsisht 4,828,677,230 lekë), nuk është parashikuar mënyra e lëvrimit të shumave të huas nga Fondi Kuvajtian. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ky lëvrim është kryer si më poshtë:

- Pas marrjes së aplikimit nga FSHZH, Fondi Kuvajtian urdhëron Bankën Kombëtare të Kuvajtit për disbursimin e shumave të aplikuara dhe në këtë moment njoftohet edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë me anë të dokumentit *Debit Advice* për urdhër transfertën;

- Nga Banka Kombëtare Kuvajtiane shuma lëvrohet në një llogari në B.N.Y;

- Kjo shumë kalon më pas nga B.N.Y në llogari të kontraktorit apo konsulentit, sipas rastit.

Mos parashikimi i procedurës dhe afatit të nevojshëm për lëvrimin e fondeve deri në llogarinë e përfituesit final si dhe kalimi i pagesave në hallkat e mësipërme ka sjellë si rezultat vonesa në disbursimin e pagesave pjesore (IPC), duke mos u respektuar afatet e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes së punimeve dhe asaj të konsulencës e duke e ekspozuar FSHZH si implementues të Projektit ndaj riskut për penalitete nga ana e Kontraktorëve (*Claim*). Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, pika 18.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 23 – 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që, në fazën e negociemeve me donatorët, draft - Marrëveshjet Financiare të përfshijnë edhe mënyrën e lëvrimin të shumave të huas në llogari të përfituesit final.

Në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Nga FSHZH të merren masa në të ardhmen që gjatë lidhjes së kontratave të cilat financohen nga donator të huaj në afatet e pagesave të parashikuara në to, të përfshihen edhe afatet të cilat i duhen donatorit për të kryer disburimin final për pjesën takuese, duke shmangur penalitetet e mundshme.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, rezulton se Kontraktori A. ka nisur punimet në datën 30.03.2017 me njoftimin për fillimin e punimeve nga mbikëqyrësi i përkohshëm i emëruar nga klienti (FSHZH). Me Vendimin nr. 04, datë 27.03.2017 të Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH (Klienti), është emëruar z. Xh. N. si mbikëqyrës i përkohshëm i punimeve për objektin “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës aksi Selenicë-Kuç-Qeparo*” Lot 1. Në fakt veprimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë rezultuar në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 3, pika 4, të Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, për zgjedhjen e konsulentit. Gjithashtu, nuk është respektuar Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998, neni 122 pika 2 ku përcaktohet përparësia e marrëveshjeve ndërkombëtare, në rastin kur ligjet e vendit nuk pajtohen me të. Në shkresën e kontraktorit Ref. Nr. ATM/BA/pmt/006 datë 09.06.2017, drejtuar klientit (FSHZH), është bërë me dije mungesa e funksionimit të mbikëqyrësit të përkohshëm. Me shkresën e sipërcituar është njoftuar klienti (FSHZH), se nuk është marrë akoma njoftimi zyrtar për fillimin e punimeve, gjithashtu nuk është rishikuar nga mbikëqyrësi i përkohshëm programi në vendin e punimeve dhe përcaktimi i buxhetit me ndryshimet e mundshme përkatëse. Kërkesa e sipërcituar nga Kontraktori është mbështetur në Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, ku përcaktohet se inxhinieri (konsulenti) i caktuar nga punëdhënësi vepron si inxhinier për qëllimet e kontratës dhe jo si inxhinier thjesht i emëruar. Gjithashtu, sipas pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b) inxhinieri siguron aprovimin specifik përpara se klienti (FSHZH) të ushtrojë autoritetin e tij. Mbikëqyrësi i përkohshëm, gjatë periudhës 30.03.2017-31.01.2018, nuk ka mundur të ushtrojë veprimtarinë e tij për kontrollin dhe certifikimin e punimeve të kryera. Mbikëqyrësi, duke qenë një individ i emëruar, nuk plotësonte kushtet lidhur me kapacitetet e konsulentit të parashikuara në termat e referencës, ku është parashikuar një staf me disa inxhinierë mbikëqyrës në vend, inxhinierë të kontrollit të cilësisë, inxhinierë topograf, si edhe specialist ambienti, etj. Qëllimi i shërbimit të

mbikëqyrjes (konsulentit apo inxhinierit), konform pikës 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi), është të sigurojë implementimin e projektit në përputhje me vizatimet dhe specifikimet teknike, si dhe të sigurojë që shërbimet teknike të jenë të lidhura me interpretimet e dokumenteve të kontratës, kontrollin e shpenzimeve, certifikimin e materialeve, volumet dhe faturat e dorëzuara nga Kontraktori, gjithashtu, ndryshime të tilla të projektit dhe specifikimeve teknike që bëhen të domosdoshme gjatë realizimit të projektit. Nga ana e klientit (FSHZH) nuk është provuar me dokumente, raportime dhe akte që mbikëqyrësi i përkohshëm të ketë ushtruar kontrollet e sipërpërmendura, orientimet (instruksionet), dhe certifikimet e punimeve përkatëse. Nga auditimi konstatohet se Kontraktori ka kryer punime në vlerën prej **686,634,246 lekë** pa TVSH për periudhën 30.03.2017-30.01.2018, dhe për shkak të mungesës të funksionimit të mbikëqyrjes (certifikimin e punimeve dhe miratimit të situacioneve përkatëse) nuk ka marrë asnjë pagesë. Kontrata e shërbimit të konsulencës për projektin “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës*”, ndërmjet FSHZH dhe konsulentit J.E. është lidhur në datë 18.01.2018, ndërkohë që punimet kishin filluar në datë 30.03.2017. Nga shërbimi i konsulencës është miratuar Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës (IPC) nr. 1 datë 21.05.2018 për periudhën e punimeve 30.03.2017-31.03.2018 dhe për volumet që janë mbështetur me dokumente justifikues, në vlerën prej **395,110,145.00 lekë** ose 23.7 % e vlerës gjithsej prej 1,669,014,765 lekë pa TVSH, të parashikuar në preventivin fitues të tenderit. Sa sipër, Kontraktori ka patur një progres të ulët të kryerjes së punimeve. Certifikata e Ndërmjetme e Pagesës nr. 1 (IPC nr. 1) është dorëzuar nga Kontraktori për shqyrtim tek konsulenti në datë 24.04.2018. Certifikata e Marrjes në Dorëzim (TOC) është lëshuar nga konsulenti në datën 26/11/2019. Certifikata Finale e Pranimi, pas periudhës së përgjegjësisë për defektet, është lëshuar në datën 26.11.2020. Veprimet e Fondit Shqiptar të zhvillimit rezultojnë në kundërshtim me Kushtet e Aplikimit të Posaçëm, pjesa II A, pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) e kontratës CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017 dhe pikës 5 në kushtet e sipërpërmendura, nën-pika 2.1(b), gjithashtu në kundërshtim me pikën 1 shkronja d) të Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi) si dhe me kushtet teknike të parashikuara në projektin e zbatimit, duke shkaktuar si pasojë kryerjen e punimeve nga Kontraktori pa miratimin paraprak dhe pa certifikimin e konsulentit, në vlerën prej 686,634,246 lekë pa TVSH. Këtë e vërteton jo vetëm fakti se për periudhën në fjalë Kontraktori nuk ka përfituar asnjë pagesë nga klienti, por edhe fakti që punimet e kryera për periudhën e mësipërme janë certifikuar për herë të parë nga konsulenti i përzgjedhur J. E., i cili ka filluar veprimtarinë në fillim të Shkurtit 2018. Veprimet e Klientit në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator kanë shkaktuar rritjen e riskut për kryerjen e punimeve jashtë standardeve të parashikuara në specifikimet teknike. Faktikisht sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga inspektimi në vendin e punimeve të konsulentit, në datat 19-20 Qershor 2018, është gjetur se Kontraktori nuk ka përmbushur specifikimet teknike për shtresën e zhavorrit të imët (ana e djathtë e rrugës) në seksionet si më poshtë:

-km 1+600-km 1+670 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur 5-10 cm

- km 1+950-km 2+125 gjerësia e seksionit tërthor e shtresës është gjetur më pak se 10 cm.

Sipas seksionit 28.02, pika 4 e Specifikimeve Teknike, gjerësia e seksionit tërthor të shtresës duhet të ishte 20 cm. Sa më sipër, veprimet e klientit kanë shkaktuar përfundimin e kontratës CWC/ICB/2016/1 me rreth 44 muaj, nga 39 muaj të parashikuara (përfshi 3 muaj shtesa e miratuar). Sa më sipër është në kundërshtim me Marrëveshja e Huas, neni IV seksioni 4.04, seksioni 4.05, Shtojca 3, pika 4 e Marrëveshjes së Huas datë 30.03.2016, Neni 122 pika e ligjit nr. 8417, datë 22.11.1998 “*Kushtetuta e Shqipërisë*”, Pika 1, nën-pika 1.1.(a) (iv) II A e kontratës punimeve CWC/ICB/2016/1 datë 24.02.2017, Pika 5, nën-pika 2.1(b) e Kushteve të kontratës së punimeve II A, pika 1 shkronja d) e Udhëzimit për Konsulentët të Fondit (Huadhënësi).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i FSHZH me Departamentin e Menaxhimit të Projekteve dhe Njësinë përkatëse të Menaxhimit të Projektit të analizojnë rezultatet e dy loteve të para të projektit “*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës*”, si edhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për një koordinim më të mirë midis aktorëve përgjegjës për realizimin e projektit brenda afateve të parashikuara nga Marrëveshja e Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Arab.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “*Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos*” rezulton se me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D. A. dhe përfaqësuesve të S. z. M. M. dhe z. I. T. me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit, kërkesa e kontraktorit S. për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E. në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE R. në masën 45 %.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht: “*Projektin e Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesave pjesore IPC; Fletëve të Matjes (Measurement Sheets)*”; Etj. si dhe nga verifikimi i kryer në terren rezultoi se:

- Gjendja e skarpateve në një pjesë të tyre ishte problematike pasi në shumë raste realizimi i tyre nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit, pra nuk është kryer në plan të rrafshët por është kryer me diferenca të dukshme duke lënë në shumë raste edhe gjurmët e gërmimit me ekskavator apo me mjete të tjera. Në rastet kur janë hasur materiale shkëmbore, gërmimi nuk është kryer sipas seksionit tërthor të pasqyruar në vizatimet sipas faktit.

Për rrjedhojë nuk është arritur të sigurohet qëndrueshmëria e skarpateve duke bërë që në shumë raste kanalet të jenë me material të rrëzuar nga këto skarpate. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e firmës sipërmarrëse punimet në skarpate janë kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të kontratës pasi në pjesën më të madhe të tyre, skarpatat rezultuan të shembura dhe/ose jo të qëndrueshme, me material të shkrifët në rrugë, kanalet rezultuan të mbushur me materialin e rrëzuar nga skarpatat dhe në shumë raste masivet e gurëve me dimensione të konsiderueshme ishin në rrugë duke u bërë kështu një shkak i mundshëm për ndodhjen e aksidenteve.

Nga verifikimi i Grupi i Auditimit të gjithë aksit për të dy segmentet dhe rezultoi se situata e skarpateve dhe pjesërisht ajo e kanaleve ishin tejet problematike.

Konkretisht, referuar specifikimeve teknike Seksioni 4, pika 4.01, nga verifikimi në terren u konstatua se në shumë raste këto pjerrësi nuk përputheshin me projektin e zbatimit. Kjo mos përputhje qëndronte në ndryshimin e këndeve të pjerrësisë mes vizatimit dhe faktit, apo masive të pa gërmuara në skarpatë të cilat nuk krijonin një plan të rrafshët ashtu siç edhe është paraqitur detaji i projektit mbi të cilin janë kryer edhe volumet e punës për pagesat e kryera ndaj kontraktorit të punimeve S. Për rrjedhojë rezulton se nuk është treguar kujdes i veçantë në dhënien e formës ekzakte të pjerrësive dhe përveç kësaj, këto pjerrësi nuk janë kryer në përshtatje me karakteristika fiziko – mekanike të formacioneve.

Gjithashtu në dosje nuk disponohen testet e nevojshme që janë kryer në laboratorin e kantierit në lidhje me natyrën e formacioneve, shkallën e tyre të kompaktësisë dhe përmbajtjen e lagështisë.

Për sa i takon kanaleve të betonit në shumë raste u konstatua mos respektim i detajeve të projektit, kryesisht për sa i përket formës lineare, estetike në dimensione në disa raste dhe pa respektuar as trashësinë dhe vendosjen e hekurit sipas kërkesave të projektit.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe*

Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P. E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të skarpateve gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit, për kryerjen e një azhurnimi topografik, me qëllim saktësimin e volumeve të punimeve të kryera dhe korrigjimin (në rast të konstatimit të ndryshimeve) të volumeve të situacionit përfundimtar të zërave që preken nga këto ndryshime.

Menjëherë

6.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH, në rolin e investitorit dhe njëkohësisht e Klientit në kontratën e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe BOE P.E., nisur nga problematikat e konstatuara në drejtim të kanaleve anësore të betonit gjatë inspektimit në terren në prezencë të Audituesve, përfaqësuesve të FSHZH dhe konsulentit ku u konstatua mungesa e respektimit të dimensioneve dhe materialit përforcues (hekur), për kryerjen e sondazheve shtesë me qëllim identifikimin e të gjitha rasteve të tjera ku nuk janë respektuar detajet e projektit të miratuar. Pas kryerjes së këtyre sondazheve, në rast të konstatimit të ndryshimeve nga ato të deklaruara në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të reflektohen ndryshimet në volume dhe në vlerë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, konkretisht:

- Projektit të Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built);
- Pagesave pjesore;
- Fletëve të Matjes (Measurement Sheets);
- Praktikave të Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3;
- Korrespondencave mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve;
- Etj.,

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të pakryera në fakt. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kodi i Preventivit	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	E/1.2	Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 1.0 m3, në kanale me gjerësi > 2 ml, tokë e zakonshme, kat. IV me shkarkim në mjet	695,700
2	E/1.8	F.V Tub PVC ϕ - 90 mm	611,414
SHUMA			<u>1,307,114</u>

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

- Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,307,114 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit OE A. për punime të pakryera dhe/apo të kryera jo në përputhje me kërkesat e projektit por të likuiduara në kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 24.02.2017 me nr. CWC/ICB/2016/1 me objekt ‘Rindërtimi i rrugës Vlora bypass – Peshkepi – Ura Gjorm Lot I’.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratave për punime civile, konkretisht: *Projektit të Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesave pjesore; Fletëve të Matjes (Measurement Sheets); Praktikave të Urdhër Ndryshimeve (Variation Order) nga VO nr. 1 deri tek VO nr. 3; Korrespondencave mes Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), Konsulentit dhe Kontraktorit të punimeve; Etj.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) nga auditimi rezulton se në lidhje me zërin Tek kategoria E, Zëri D/10 Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit, sipas librezës së masave dhe situacionit përfundimtar janë pasqyruar volumni total prej 18,847.37 m². Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konkretisht materialeve fotografike të dosjes teknike si dhe verifikimit në terren në prezencë të konsulentit dhe përfaqësuesve të FSHZH, konstatohet se ky volum në disa raste është kryer me material zhavorri të përzier me tokë vegjetale. Pavarësisht sa më sipër rezulton se kanalet rezultojnë të qëndrueshme dhe pa devijime apo mangësi të drejtim të shfrytëzimit të rrugës. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se tek kategoria G Punime Bioinxhinierike, Zëri G/2 Rrafshim skarpate në gjërmim, konstatohet se sipas librezës së masave (dokumenti Measurement Sheets), janë pasqyruar volumni për rrafshimin e skarpateve prej 90,751.71 m². Në fakt, referuar verifikimit në terren të punimeve faktike në prezencë të supervizorit si dhe kronologjisë së punimeve arrihet në konkluzionin se volumnet e punës për këtë zë janë kryer gjatë punimeve të gjërmimit nën zërat ‘Gjërmim në tokë kategoria III seksion i detyruar për formimin e trupit të rrugës me ekskavator me zinxhir 1m³ përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gjërmim në tokë kategoria IV seksion i detyruar me ekskavator 1m³ me zinxhir për formimin e trupit të rrugës përfshirë shkallëzimin e skarpateve në seksionet në mbushje, sipas profileve’, ‘Gjërmim

në tokë kategoria III për heqjen e tokës vegjetale seksion të lirë me ekskavator me zinxhirë 1m³, ‘Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet’ si dhe zërin ‘Gërmim në tokë kategoria III për gjerësi kanali deri në 2 m me ekskavator me zinxhir 0.5m³ me shkarkim në mjet’. Gjithashtu, konstatohet se nën këtë zë janë likuiduar edhe volume pune për rrafshimin e materialeve shkëmbore, rrafshimin e kanaleve si dhe rrafshimin e sheshpushimeve të shkallëzimeve. Referuar Specifikimeve teknike, pika 4.05 rezulton se është cituar se: *Gërmimet e Përgjithshme përbëhen nga gërmimet për hapjen e rrugës, vendeve të ndërrimit dhe pune ndihmese si për shembull, gërmimet për segmente të rrugës në prerje, nivelimi i dherave, rregullimi i skarpateve në gërmim apo mbushje, formimi dhe thellimi i bazamentit të mbushjes, kanalet anësore, kanalizimet e nëndheshme, kanalet etj., si edhe ato për themele të strukturave.*

Nga verifikimi në terren rezultoi se në disa raste skarifikimi i skarpateve nuk është kryer sipas skicës së librezës së masave dhe projektit (nuk është kryer në plan të rrafshët) por është kryer me diferenca. Për rrjedhojë rezulton se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumë **11,467,645 lekë pa TVSH**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

- Artikulli 3 Obligimet e Kontraktorit tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: FSHZH të marrë masa për shmangien e praktikave në të cilat konstatohen mbivendosje zërash të ndryshëm për të njëjtët procese pune me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve të projekteve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektin “Loti II - Ura e Gjormit, Brataj – Ura Laskos” rezulton se me datë 17.04.2019 është lidhur kontrata mes Titullarit të AK z. D. A. dhe përfaqësuesve të S. z. M. M dhe z. I.T me vlerë 4,236,665,117 lekë me TVSH. Sipas shkresës me nr. 828/3 prot., datë 21.04.2020 është miratuar nga ana e Titullarit, kërkesa e kontraktorit S. për nën kontraktimin e një pjese të punimeve tek operatori E. në masën 45 % dhe përmes shkresës nr. 828/2 prot., datë 21.04.2020 është miratuar kontraktimi i punimeve tek OE R. në masën 45 %.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e punimeve, konkretisht:

- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit, As-Built); Pagesat pjesore IPC; Fletët e Matjes (Measurement Sheets); Etj.*

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe Konsulentit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave (Measurement Sheets) dhe në situacionin përfundimtar volume pune të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në shumën prej 129,292,638.45 lekë pa TVSH në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
Segmenti 1 Ura e Gjormit - Brataj		
1	Gjeotekstil me gramaturë 200 g/m ²	317,795
2	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	1,733,535.79
3	Gërmim në shkëmb seksion i detyruar me ekskavator 0.5 m ³ me zinxhir me gjerësi kanali 2 m me shkarkim në mjet	427,063
4	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	5,904,329
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	1,853,189
6	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	3,921,855.09
7	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	1,667,022.8
8	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	930,581.6
9	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	2,118,142
10	Rrafshim skarpate në gërmim	1,371,810
11	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	462,742.89
12	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	940,401.79
13	Punimet e gërmimit në seksionin në piketën 5+831	3,665,808
14	Transporti i materialit të gërmuar	23,692,449.49
SHUMA Segmenti 1		45,340,917.45
Segmenti 2 Brataj – Ura e Laskos		
1	Shtresë stabilizant t=10 cm për bankinat	3,230,033.63
2	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	8,216,401
3	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kanalet e betonit, sipas vizatimeve	1,451,613
4	F V hekur betoni i zakonshëm për kanalin e betonit Ø 6 ~ 10mm	2,045,659
5	Struktura të holla monolite betoni të armuara C 20/25 për kunetat e betonit, sipas vizatimeve	5,412,793.44
7	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm për kanalet e betonit	6,155,009.91
8	Volume për punime gërmimi për zërin e mësipërm	2,098,985
9	Volume për transportin e materialit të pa gërmuar gërmimi për zërin e mësipërm	1,374,436.44
10	Mbjellje me bar e skarpateve dhe mbushje me dhe vegjetal t = 20 cm	10,574,022.5
11	Rrafshim skarpate në gërmim	3,086,247.46
12	Transporti i materialit zhavorr të pa gërmuar në fakt për Fibrat Optike	834,002.45
13	Mbushje me zhavorr për Fibrat Optike	1,670,423.39
14	Mbushje, përhapje dhe ngjeshje me zhavorr në trupin e rrugës	1,098,010
15	Transporti i materialit të gërmuar	36,704,083.86
SHUMA Segmenti 2		83,951,721
TOTAL		129,292,638.45

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, pika 8.1, Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, Kontrata e shërbimit të konsulencës e lidhur me datë 18.01.2018 mes FSHZH dhe konsulentit:

- Artikulli 3 *Obligimet e Kontraktorit* tek Kushtet e përgjithshme të Kontratës, pika 3.1.1 dhe 3.1.2;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika II Përshkrimi i Projektit, qëllimi i shërbimeve, detyrat dhe objektivat e pritshëm Qëllimi i Shërbimeve;
- Shtesa A – Përshkrimi i Shërbimeve, Pika III. 3 Kontrata e Shërbimit, Aktivitete gjatë fazës së Ndërtimit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 31 – 41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e FSHZH të merren masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës me qëllim analizimin e vlerës **129,292,638.45 lekë pa TVSH** në lidhje punët e kryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe/apo të kryera jo sipas përshkrimeve të bëra në situacionin përfundimtar, kjo përmes edhe një verifikimi më të plotë në terren⁶ si dhe nxjerrjen e një konkluzioni për kontratën e sipërmarrjes të lidhur me datë 17.04.2019 me objekt ‘*Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës, Loti 2 Segmenti Ura e Gjormit – Brataj Ura a Laskos*’.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e FSHZH, kërkojmë nga Drejtori Ekzekutiv fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

⁶ Ky rekomandim është vendosur nisur nga pretendimet e subjektit të audituar se gjatë verifikimit në terren GA realizoi sondazhe jo për çdo km por në disa pika të rastësishme.

V. ANEKSE

Aneksi 1.1.1 Mbi marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet e saj nëse ka, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimit. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

Aneksi 1.1

1. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 50/2016, *“Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës”.*

Kjo marrëveshje ka parashikuar përfundimin e Projektit më datë 31.12.2019, përfundimin e afatit të disbursimit më datë 31.12.2020 si dhe financimin sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1.1

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	<u>Ndërtimi i punimeve civile</u>	9,913,000	77 %
2	<u>Shërbime Konsulence</u>	777,000	100 %
3	<u>Kontigjenca të pa alokuara</u>	1,310,000	
	TOTAL	12,000,000	

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kjo marrëveshje është amenduar me VKM nr. 178 datë 26.02.2020 *“Për miratimin e Marrëveshjes Ndryshuese, me Shkëmbim Letrash, të Marrëveshjes së Huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit, për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, ratifikuar me ligjin nr. 50/2016”* me të dhëna sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1.2

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e kostos totale të zërit
1	<u>Ndërtimi i punimeve civile</u>	11,223,000	77 %
2	<u>Shërbime Konsulence</u>	777,000	100 %
3	<u>Kontigjenca të pa alokuara</u>	0	0
	TOTAL	12,000,000	

2. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 100/2017, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”.*

Sipas Shtojcës nr. 1 të saj, janë parashikuar zërat që do të financohen me fondet e kësaj Huaje për çdo kategori si dhe përqindja e shpenzimeve për tu mbuluar nga Fondi Saudit. Konkretisht:

Tabela nr. 1.3

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Rial Saudit)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1	<u>Punime civile, Pjesa 1-B e Projektit</u>	95,000,000	100 %
2	<u>Shërbime Këshillimi, Pjesa 2-B</u>	7,500,000	100 %
3	<u>Të pacaktuara</u>	10,000,000	
	TOTAL	112,500,000	

Sipas dokumentacionit të dërguar me observacion, me shkresën e administruar në KLSH me nr. 549/3 prot., datë 27.08.2020 rezulton se kjo marrëveshje është në fazë negociimi me qëllim rialokimin e shumave të Huas në projekte të tjera më prioritare.

3. Marrëveshja e ratifikuar me Ligjin nr. 47/2020, *“Për ratifikimin e Marrëveshjes për një Hua shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e Projektit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”.*

Në pjesën përshkruese të projektit, tek ANEKS 2, *Përshkrimi i Projektit* shërbimet e konsulencës inxhinierike është bërë ndarja dhe specifikimi për 3 lotet:

Loti 1: Vlorë – Gjorm, me gjatësi përafërsisht 23 km;

Loti 2: Gjorm – Ura e Laskos, me gjatësi përafërsisht 24 km;

Loti 3: Ura e Laskos – Qeparo, me gjatësi përafërsisht 27 km;

Sipas ANEKS 3 të kësaj marrëveshjeje, *Lista e mallrave që do të financohet nga huat* janë përshkruar zërat që do të financohen me fondet e kësaj Huaje për çdo kategori si dhe përqindja e shpenzimeve për tu mbuluar nga Fondi Kuvajtian duke ndryshuar shumat e marrëveshjes së mëparshme si më poshtë. Konkretisht:

4. Tabela nr. 1.4

Nr.	Zëri	Alokimi i shumave (Dinarë Kuvajtian)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
1	<u>Punimet e ndërtimit</u>	18,023,000	77 %
2	<u>Shërbimet e konsulencës</u>	777,000	100 %
	TOTAL	18,800,000	

Deri në fund të periudhës objekt auditimi kjo marrëveshje nuk rezulton të jetë ndryshuar dhe është ende në fuqi sipas parashikimeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT